

RAPORTI I PARALAJMËRIMIT TË HERSHËM I KOSOVËS

Raporti nr. 20/21 Edicion Special
Janar – Qershor 2008

Stabiliteti politik dhe institucional
Stabiliteti ekonomik dhe social
Marrëdhëniet ndëretnike
Siguria publike dhe personale
Ngjarjet e Marsit
Analiza të Korrupsionit

Qershor 2008

Pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë të ekspertëve dhe të të intervistuarve, dhe nuk i shprehin domosdo pikëpamjet e UNDP-së apo të USAID-it.

Grupi i Ekspertëve:

Arben Çollaku – University of Staffordshire, Kandidat magjistature
Artan Duraku – Këshilltar Politik, Ministria e Punëve të Brendëshme
Bujar Haziri – Zyrtar për Rini, Komuna e Gjilanit
Enver Bajçinca – Ekonomist / Konsulent
Figen Kazaz – Asistente e Projektit SIKYAP, UNDP
Lumir Abdixhiku – Drejtor Menagjues, Instituti Riinvest
Mimoza Dushi – Demografe, Universiteti i Prishtinës
Mimoza Polloshka – Sekretare Bordi, Qendra Kërkimore e AUK-së
Sevdije Vranja – Oficere e Policisë së Komunitetit, SHPK
Shqipe Pantina – Zyrtare e Lartë e Programit, IREX-KCSP
Xhevat Latifi – Korrespondent/Gazetar, RTK

Analiza të Korrupsionit nga:

Mytaher Haskuka – Analist i Programit, UNDP

Shkruar nga:

Faton Bislimi – Menagjer i Projektit të SPH-së, UNDP
Iris Duri – Statisticiente e SPH-së, UNDP
Mytaher Haskuka – Analist i Programit, UNDP

Produksioni: Rrota, www.rrota.com

Layout: Arbër Matoshi
Korab Etemi

Ballina: Kushtrim Balaj

Komentet dhe reagimet tuaja janë të rëndësishme për hartimin e mëtejshëm të raporteve.
Luteni që të njëjtat t'i dërgoni në: early.warning.ks@undp.org

Regjionet Gjeografike të Kosovës



Treguesit e Përzgjedhur Ekonomikë

	Jan-Mar 2005	Pri-Qer 2005	Korr-Shta 2005	Tet-Dhje 2005	Jan-Qer 2006	Korr-Shta 2006	Tet-Dhjet 2006	Jan-Mar 2007	Pri-Qer 2007	Korr-Tet 2007	Nen-Dhjet 2007	Jan-Qer 2008	Trend
Popullata (në ,000) (a)				1,999*			2,033**	2,07**	2,07**	2,1**	2,1**	2,1**	◀▶
Shkalla e rritjes së BPV-së (vjetore), % (a)				0.3			3.0			3.5	3.5 (o)	3.5	▲
BPV-ja për kokë banori, € (a)				1,120 (a)			1,117 (a)			1150	1150 (q)	1,150	◀▶
BKK (vjetor), milionë € (b)				641.5			713.2 (l)	553** (m)	553 (m)	553 (m)		862.13	▲
Dërgesat e punëtorëve, milionë €				281.0 (a)			318.0 (a)			398	398 (p)		▲
Ndihma nga jashtë, milionë € (a)				462.0*			465.0*			352	352 (r)		▼
Fondi i TKPK-së, milionë € ©				145.8 (Dhje)	167.5 (Maj) (d)	177 (Shta) (k)	213.0 (Dhje) (k)	230.6 (Mar)		266.5 (Shta)		273.8 (Mar)	▲
Fondi i AKM-së, milionë € (e)				113.1 (Dhje)	234.9 (Pri)	256.1 (Gush) (h)	275.0 (Dec)	291.6 (Shku)		384.4 (Tet)			▲
Depozitet në banka, milionë €	704.8 (Shku)	731.2 (Maj)	765.8 (Gush)	809 (Nen)	844.6 (Pri) (e)	881.6 (Gush) (h)	926.4 (Dhje)	973.5 (Shku)	967.6 (Pri)	1.102.740 (Tet)	1.228 (Dhje) (s)	1.112 (Shku)	▼
Huat nga bankat komerciale, milionë €	356.5 (Shku)	400.1 (Maj)	401.8 (Gush)	435.7 (Nen)	459.7 (Pri) (e)	476.4 (Gush) (h)	490.5 (Dhje)	515.1 (Shku)	560.2 (Pri)	659.9 (Tet)	891.2 (Dhje) (t)	937 (Shku)	▲
Bilanci tregtar, milionë € (j)	-219.1 (Jan-Mar)	-308.5 (Jan-Pri)	-723.4 (Jan-Gush)	-1028.4 (Jan-Nen)	-537.5 (Jan-Jun)	-761.3 (Jan-Gush) (j)	-1235.3 (Jan-Dhje)	-101.92 (Jan-Shku)	-400 (Jan-Pri)	-1164.2 (Jan-Tet)	-264.6 (Nen-Dhje) (n)	-360 (Jan-Shku)	▲
Punëkërkuarit e regjistruar	303,095 (Jan)	311,230 (Maj)	314,446 (Gush)	319,721 (Dhje)	323,201 (Maj)	324,835 (Shta)	326,026 (Dhje)	331,056 (Mar)			334,595 (Dhje)		▲
Indeksi i çmimeve të konsumit, % (krahasuar me majin 2002) ***	101.4 (Maj)	100.0 (Maj)	98.5 (Gush)	101.9 (Nen)	102.9 (Maj)	101.3 (Gush) (f)	102.6 (Nen)	100.2 (Mar)	99.4 (Apr)	103.9 (Shta)	102.8 (Dhje)	111.4 (Shku)	▲
Pensionitë mujor, €	40	40	40	40	40	40	40	40	40	40	40	40	◀▶

* I vlerësuar

** I paraparë

*** Në janar 2006, ESK-ja e ndryshoi metodologjinë e caktimit të IÇK-së. Kështu që krahasimi i IÇK-së së tanishme me IÇK-në para janarit 2006 nuk është i mundshëm

Burimet:

- FMN (2007), Aide Memoire i FMN-së, Misioni i ekipit të FMN-së në Kosovë, 19-27 shkurt 2007.
- MEF (2006), Buxheti 2006, MEF, Qeveria e Kosovës, Prishtinë.
- TKPK (2005), Raporti vjetor 2005, TKPK, Prishtinë.
- Vlerësimi i marrë prej TKPK-së përmes postës elektronike.
- AQBK (2006), Buletini mujor i statistikave, nr. 56, BPK, Prishtinë, prill 2006.
- ESK (2006), Divizioni i statistikave të çmimeve, Indeksi i Çmimeve të Konsumit, ESK, Qeveria e Kosovës, Prishtinë. Shifrat e tjera janë të UNDP-së (2006), Raporti i paralajmërimit të hershëm nr.12: tetor-dhjetor 2005, UNDP, Prishtinë, op. cit.
- Komisioneri i Lartë për Refugjatët i Kombeve të Bashkuara për Kosovë.
- BPK (2006), Buletini mujor i statistikave, nr. 56, Prishtinë, gusht 2006.
- Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, 2006.
- Kjo është në deficitin tregtar për periudhën jan-shkurt 2007, Enti Statistikor i Kosovës.
- Kjo shifër është raportuar në faqen e internetit të TKPK-së, data e futjes në faqe, 7 shkurt 2007
- AQBK (2007). Buletini mujor i statistikave për dhjetor 2006. nr (64). Prishtinë.
- Ministria e Ekonomisë dhe e Financave e Kosovës – Raporti i parë tremujor 2007
- Enti Statistikor i Kosovës , 2007 (në mil. Euro për Nën-Dhje 2007)
- AQBK – Buletini Nr. 78, Shk 2008
- AQBK – Buletini Nr. 78, Shk 2008, në mil. Euro për vitin 2007
- AQBK – Buletini Nr. 78, Shk 2008 në Euro
- AQBK – Buletini Nr. 78, Shk 2008 në mil. Euro
- (s), (t) AQBK – Buletini Nr. 78, Shk 2008 në mil. Euro

Treguesit e Përzgjedhur nga Hulumtimi i Opinioneve Publike

	Mar 2005 a)	Qer 2005 a)	Shta 2005 a)	Dhje 2005 a)	Qer 2006 a)	Shta 2006 c)	Dhje 2006 d)	Mar 2007 e)	Qer 2007 f)	Tet 2007 g)	Dhje 2007 h)	Maj 2008 m)	Trendi
Pesimizmi politik, % ("shumë të pakënaqur" apo "të pakënaqur" me trendët aktual politikë)	38.6	35.8	41.0	40.2	43.4	38.7	48.9	50.0	54.0	53.0	41.1	30.7	▼
Pesimizmi ekonomik, % ("shumë të pakënaqur" apo "të pakënaqur" me trendët aktual ekonomikë)	71.1	69.9	68.8	73.3	76.0	70.0	76.2	76.1	70.7	63.8	64.6	52.1	▼
Gatishmëria për të protestuar për shkaqe ekonomike, %	62.9	63.5	57.4	69.3	62.8	44.0	42.8	46.0	54.9	69.5	71.3	68.4	◀▶
Gatishmëria për të protestuar për shkaqe politike, %	48.9	48.4	45.4	56.2	45.5	30.6	30.9	28.6	31.2	59.4	58.6	47.6	▼
Kënaqshmëria me punën e UNMIK-ut*, %	29.7	41.4	34.5	35.9	30.5	29.9	28.0	26.1	31.5	29.2	27.7	47.9	▲
Kënaqshmëria me punën e PSSP-së*, %	81.2	81.7	69.8	72.0	70.5	34.5	43.6	38.3	45.9	32.4	39.6	49.4	▲
Kënaqshmëria me punën e IPVQ-ve*, %	81.2	67.7	48.7	51.0	43.3	27.2	27.2	34.2	35.9	28.1		46.9	
Kënaqshmëria me punën e Kuvendit*, %	73.7	63.0	59.0	56.2	45.4	43.0	25.6	34.6	31.9	36.2	36.7	51.4	▲
Kënaqshmëria me punën e KFOR-it*, %	81.0	87.3	84.3	86.3	81.0	83.6	77.5	75.4	81.8	76.5	83.7	89.0	▲
Kënaqshmëria me punën e SHPK-së*, %	86.9	84.4	84.5	84.2	81.8	81.5	72.5	68.5	79.3	76.9	78.6	84.7	▲
Ndjenjat e pasigurisë ("Disi të pasigurt" apo "shumë të pasigurt" kur gjendemi jashtë shtëpisë)	38.1	36.6	36.7	42.9	35.5	42.7	38.6	43.7	22.6*	54.38*	55.25*	24.63*	▼

Burimet:

- UNDP (2006), Raporti i paralajmërimit të hershëm nr. 12: tetor-dhjetor 2005, UNDP, Prishtinë, op. cit.
- UNDP (2006), Hulumtimi i opinionit publik: janar-qershor 2006.
- UNDP (2006), Hulumtimi i opinionit publik: korrik-shtator 2006.
- UNDP (2006), Hulumtimi i opinionit publik: tetor-dhjetor 2006.
- UNDP (2006), Hulumtimi i opinionit publik: janar-mars 2007.
- UNDP (2006), Hulumtimi i opinionit publik: prill-qershor 2007.
- UNDP (2007), Hulumtimi i opinionit publik: korrik-tetor 2007.
- UNDP (2007), Hulumtimi i opinionit publik: dhjetor 2007.
- UNDP (2007), Hulumtimi i opinionit publik: maj 2008.

Përmbajtja

Parathënie.....	13
Përmbledhje e përgjithshme	15
Metodologjia	15
STABILITETI INSTITUCIONAL DHE POLITIK I KOSOVËS	17
I. Kënaqshmëria me institucionet e Kosovës	17
II. Përgjegjësia për gjendjen politike të Kosovës	20
III. Kosova e passtatusit	21
IV. Përfundimet e Grupit të ekspertëve mbi çështjet e stabilitetit institucional dhe politik	25
STABILITETI EKONOMIK DHE SOCIAL I KOSOVËS	27
I. Një pasqyrë e përgjithshme ekonomike	27
II. Përgjegjësia për gjendjen ekonomike dhe mundësia e protestave për shkak të arsyeve ekonomike	29
III. Konkludimet e grupit të ekspertëve mbi çështjet e stabilitetit ekonomik dhe social	31
MARRËDHËNIET NDËRETNIKE	33
I. Trendët kryesorë	33
II. Kontaktet ndëretnike dhe bashkëjetesa	34
III. Përfundimet e grupit të ekspertëve në çështjet ndëretnike	35
SIGURIA PUBLIKE DHE PERSONALE	37
I. Kënaqshmëria me institucionet e sigurisë	37
II. Siguria personale dhe familjare	38
III. Armët e zjarrit dhe shpërbërja e Trupave të Mbrojtjes së Kosovës	40
IV. Përfundimet e Grupit të ekspertëve për çështjet e sigurisë publike dhe personale	42
NGJARJET E MARSIT: NDIKIMI I TYRE NË ÇËSHTJET E SIGURISË DHE MARRËDHËNIET NDËRETNIKE	43
Analiza të korrupsionit	47

Lista e shkurtesave

AUK	Universiteti Amerikan në Kosovë
AQBK	Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
BE	Bashkimi Evropian
RPH	Raporti i Paralajmërimit të Hershëm
SPH	Sistemi i Paralajmërimit të Hershëm
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KFOR	Forca e Kosovës
TMK	Trupat Mbrojtëse të Kosovës
SHPK	Shërbimi Policor i Kosovës
FSK	Forca e Sigurisë së Kosovës
AKM	Agjencia Kosovare e Mirëbesimit
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
IPVQ	Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes
RTK	Radio Televizioni i Kosovës
EJ	Evropa Juglindore
SIKYAP	Projekti i Mbështetjes së Implementimit të Planit Kosovar të Veprimit të Rini
ESK	Enti Statistikor i Kosovës
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
KB	Kombet e Bashkuara
UNMIK	Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë
KS i KB-së	Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara
USAID	Agjensioni i SHBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtar

Parathënie

Ky është botim special i Raportit të Paralajmërimit të Hershëm të UNDP-së (RPH nr. 20, 21), Raport ky që ka filluar të botohet në gusht të vitit 2002. Ky Raport sponozorizohet nga Agjencia për Zhvillim Ndërkombëtar e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (USAID), e cila i mbulon një pjesë të shpenzimeve të RPH-së. Ky Raport është paksa më voluminoz sesa raportet e mëparshme të paralajmërimit të hershëm, pasi që përfshinë të dhënat dhe analizat e një ankete të shkurtër të organizuar kah fundi i marsit dhe fillimi i prillit të vitit 2008 (vetëm kapitulli 5) dhe të një ankete të plotë, të bërë në maj 2008. Kësaj rradhe është bërë një kombinim i RPH-në nr. 20 dhe nr. 21, për të mbuluar periudhën prej janarit deri në maj të vitit 2008. Megjithatë, Raporti i përmbahet traditës së raporteve paraprake, duke analizuar gjendjen në ndryshim e sipër në Kosovë në katër fusha kryesore: në atë politike, socio-ekonomike, ndëretnike dhe në fushën e sigurisë. Një karakteristikë e fazës IV të projektit të Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm (SPH) është se çdo raport tremujor do të bazohet në njohuritë profesionale të grupit të ndryshëm të analistëve.

Ky numër i Raportit të paralajmërimit të hershëm botohet gjatë një periudhe të zhvillimeve të reja të rëndësishme në Kosovë – siç është shpallja e Pavarësisë e datës 17 shkurt dhe miratimi i Kushtetutës së Kosovës e hyrja e saj në fuqi më 15 qershor. Në këtë drejtim, përcjellja e vazhdueshme e treguesve të paralajmërimit të hershëm mund të jetë instrument i nevojshëm për marrjen e informatave për faktorët e mundshëm të shkakimit të konfliktit, si dhe për marrjen e mendimit nga populli i Kosovës mbi procesion e passtatusit.

Botimi special i RPH-së nr. 20/21 përbëhet prej katër temave boshte: stabiliteti politik dhe institucional, gjendja socio-ekonomike, marrëdhëniet ndëretnike dhe siguria personale e ajo publike. Analiza e këtyre çështjeve kryesisht bazohet në të dhënat e anketa e opinionit publik e bërë nga Instituti Riinvest kah fundi i marsit 2008. Këto anketa të hollësishme i masin perceptimet e qytetarëve lidhur me çështjet kryesore që e preokupojnë shoqërinë e Kosovës. Disa nga thekset kryesore të këtij Raporti janë si në vijim:

- Niveli i kënaqshmërisë me institucionet kryesore qeverisëse është rritur gjatë periudhës raportuese të majit 2008 në krahasim me atë të dhjetorit 2007. Në maj 2008, përafërsisht 48% (një rritje prej 20% që nga dhjetori 2007) e të anketuarve janë të kënaqur me punën e UNMIK-ut.
- Në krahasim me rezultatet e anketës së dhjetorit 2007, niveli i kënaqshmërisë me punën e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) është rritur për gjashtë për qind.
- Përkundër rënies së shënuar prej qershorit deri në tetor 2007 si SHPK-ja, ashtu edhe KFOR-i që nga tetori 2007 kanë shënuar një rritje të vogël me përkatësisht 85% dhe 89% të të anketuarve në maj 2008, të cilët janë të kënaqur me punën e këtyre institucioneve.
- Kënaqshmëria me punën e Qeverisë së Kosovës tani për tani është 47% dhe me atë të EULEX-it është 13%.¹
- Që nga dhjetori 2007, është vërejtur një rënie prej 7 për qind (tani është 68%) në gatishmërinë e të anketuarve që të protestojë për arsye ekonomike. Ndërsa një rritje prej 13% (tani është 52%) është parë në pesimizmin ekonomik të të anketuarve që nga dhjetori 2007.
- Në krahasim me rezultatet e anketës së dhjetorit të vitit 2007, anketa e fundit tregon një rënie domethënëse prej 10 për qind të pesimizmit politik të të anketuarve (tani është 31% në krahasim me 41%, sa ishte në dhjetor 2007). Gjithashtu, është vërejtur një rënie e dukshme prej 16 për qind në gatishmërinë e të anketuarve që të protestojnë për arsye politike, ku tani kjo gatishmëri shënon shifrën prej 48% në krahasim me 64%, sa ishte në dhjetor 2007.
- Në pyetjen për rrethanat që kërcënojnë stabilitetin e Kosovës, papunësia dhe varfëria janë cekur nga të anketuarit shqiptarë dhe ata të pakicave të tjera si faktori kryesor. Ndërsa për serbët, përkeqësimi i mëtejshëm i marrëdhënieve ndëretnike paraqet faktorin kryesor që kërcënon stabilitetin e Kosovës, i cili pasohet nga sundimi jo i mjaftueshëm i ligjit.
- Numri i serbëve të Kosovës që dëshirojnë të punojnë me shqiptarët ka rënë dukshëm, dhe tani qëndron në 24%, në krahasim me 46%, sa ishte në dhjetor të vitit 2007. Sa i përket shqiptarëve, ky tregues nuk ka shënuar ndryshim të dukshëm që nga dhjetori 2007, dhe tani qëndron në 49%.

Përderisa Raporti mund të jetë interesant për lexuesit në përgjithësi, qëllimi i tij parësor është të ofrojë propozime të monitorimit dhe të parandalimit të konfliktit për akterët kyç në kuadër të Qeverisë së Kosovës dhe të udhëheqësisë vendore, si dhe për akterët zhvillimorë, Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) dhe për bashkësinë ndërkombëtare. Të gjitha përfundimet dhe rekomandimet e propozuara dhe të paraqitura në këtë Raport kanë ardhur si rezultat i disa raundeve të diskutimeve me ekspertë nga lëmenj, profesione dhe institucione të ndryshme.

Mbesim të bindur se analizat e paraqitura në botimin special të RPH-së nr. 20/21 do të stimulojnë mendime dhe diskutime të shumta në mesin e lexuesve, si dhe do të tërheqin vëmendjen e duhur të akterëve të rëndësishëm politikë dhe të tjerë në Kosovë. Andaj, kemi kënaqësinë t'ua shprehim falënderimet tona të sinqerta ekspertëve që kanë dhënë kontributin e tyre me pjesëmarrje në diskutime dhe me ofrimin e ideve, pikëpamjeve dhe interpretimeve të rezultateve të anketës, si dhe të gjithë atyre që na përkrahen në procesin e përfundimit të këtij numri të RPH-së.



Frode Mauring
Përfaqësues rezident

¹ Vërejtje: EULEX-i është vlerësuar për herë të parë gjatë kësaj ankete dhe një numër i dukshëm i të anketuarve ende nuk kanë qenë të familjarizuar me të.

Përmbledhje e përgjithshme

- Niveli i kënaqshmërisë me institucionet kryesore qeverisëse është rritur gjatë periudhës raportuese të majit 2008 në krahasim me atë të dhjetorit 2007. Në maj 2008, përafërsisht 48% (një rritje prej 20% që nga dhjetori 2007) e të anketuarve janë të kënaqur me punën e UNMIK-ut. Në krahasim me rezultatet e anketës së dhjetorit të vitit 2007, shkalla e kënaqshmërisë me Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) është rritur për gjashtë për qind. Në krahasim me rënien e shënuar mes qershorit dhe tetorit 2007 si SHPK-ja, ashtu edhe KFOR-i kanë shënuar një rritje të vogël me përafërsisht 85% dhe 89% përkatësisht të të anketuarve të majit 2008, që janë të kënaqur me punën e tyre.
- Që nga dhjetori 2007, rënia prej shtatë për qind (tani është 68%) është vërejtur në gatishmërinë e të anketuarve që të protestojnë për arsye ekonomike. Ndërsa një rënie prej 13% (tani është në 52%) është vërejtur në pesimizmin ekonomik që nga dhjetori i vitit 2007. Në krahasim me rezultatet e anketës së dhjetorit 2007, anketa e tanishme tregon një rënie të dukshme prej rreth 10 për qind në pesimizmin politik të të anketuarve (tani është 31% në krahasim me 41% sa ishte në dhjetor të vitit 2007). Për më tepër, është vërejtur një rënie e dukshme prej 16 për qind në gatishmërinë e të anketuarve që të protestojnë për arsye politike që tani është 48%, në krahasim me 64%, sa ishte në dhjetor të vitit 2007.
- Me zgjidhjen e statusit përfundimtar që më parë identifikohet si problemi madhor, me të cilin ballafaqohet Kosova që nga qershori 2007, rezultatet e anketës së majit 2008 tregojnë se papunësia është problemi madhor me të cilin ballafaqohet Kosova (33%), i pasuar me varfërinë (25%) dhe me furnizimin me energji elektrike (12%).
- Numri i serbëve që janë të gatshëm të punojnë me shqiptarët ka rënë dukshëm në 24%, në krahasim me 46%, sa ishte në dhjetor të vitit 2007. Sa i përket shqiptarëve, ky tregues nuk ka shënuar ndryshim domethënës që nga dhjetori 2007, ku tani qëndron në 49%.

- KEK-u dhe AKM-ja (që nga qershori 2007) vazhdojnë të udhëheqin listën e institucioneve të Kosovës që perceptohen si me prani "të shkallës së lartë të korrupsionit".
- Kënaqshmëria e serbëve të Kosovës me KFOR-in dhe SHPK-në ka rënë në 28% dhe në 1% përkatësisht, në krahasim me 44% dhe me 2%, sa ishte në dhjetor të vitit 2007. Përmirësimi i vetëm në kënaqshmërinë e serbëve me institucionet e sigurisë ka shënuar rritje prej resht shtatë për qind që nga dhjetori 2007, ku policia e UNMIK-ut tani ka shkallë kënaqshmërie prej 25.5%.
- Sa i përket të anketuarve shqiptarë, rreth 98% janë të kënaqur me TMK-në, 95% janë të kënaqur me KFOR-in, rreth 90% me SHPK-në dhe rreth 58% m policinë e UNMK-ut.

Metodologjia

Projekti i Sistemit të Kosovës për paralajmërimin e hershëm është komponent i kornizës regjionale të UNDP-së për paralajmërimin e hershëm. Përmes projektit tentohet të ngriten kapacitetet e analistëve vendorë që të parashohin krizat e mundshme, dhe që të japin këshilla për politikën e parandalimit të krizave. Raportet e paralajmërimin të hershëm hartohen çdo tre muaj. Projekti bashkëfinancohet nga USAID-i dhe UNDP-ja.

Anketa (maj 2008) është bazuar në intervistat sy me sy, dhe ka përfshirë 1.310 të anketuar: 874 shqiptarë, 200 serbë dhe 236 të anketuar të pakicave të tjera të Kosovës. Mostra është përzgjedhur përmes metodës së mostrës së rëndomtë dhe është shtresuar në bazë të regjioneve gjeografike që bazohen në kodet telefonike të rajoneve (7), në komuna (30) dhe me përpjesëtim urban – rural (1:1). Kjo mostër përfaqësuese e Kosovës është përlllogarit me nivel të besueshmërisë prej 95%, që nxjerrë intervalin e besueshmërisë prej (CI) of +/- 2.71.

Ky Raport i paralajmërimin të hershëm është numër special – Raporti i paralajmërimin të hershëm i Kosovës nr. 20/21, që mbulon periudhën prej janarit deri në qershor të vitit 2008, të bazuar në të dhënat nga anketa e majit 2008. Kapitulli 5 i këtij raporti është i bazuar në të dhënat e një ankete të shkurtër, të bërë kah fundi i marsit dhe fillimi i prillit 2008.

Kapitulli 1

STABILITETI INSTITUCIONAL DHE POLITIK I KOSOVËS

I. Kënaqshmëria me institucionet e Kosovës


Mes dhjetorit 2007 dhe majit 2008, shkalla e kënaqshmërisë me punën e të gjitha institucioneve të Kosovës ka shënuar rritje. Kënaqshmëria me UNMIK-un, shkalla e së cilës shënuar rënie të vazhdueshme nga qershori 2007 deri në dhjetor 2007, në maj 2008 është rritur për 20 për qind. Shkalla e kënaqshmërisë me punën e Qeverisë së Kosovës tani qëndron në 47% (IPVQ-të (tani Qeveria e Kosovës) nuk janë renditur në anketën e dhjetorit 2007 për shkak të ndryshimeve në qeveri pas zgjedhjeve të nëntorit 2007). KFOR-i tani për tani gëzon shkallën më të lartë të kënaqshmërisë në krahasim me të gjitha institucionet e tjera në Kosovë, me rreth 89% - që është njëkohësisht edhe shkalla më e lartë e kënaqshmërisë që nga gushti 2002. Rreth 85% e të anketuarve janë të kënaqur me SHPK-në, që tregon një rritje të kënaqshmërisë prej gjashtë për qind që nga dhjetori 2007. Shkalla e kënaqshmërisë me punën e PSSP-së vazhdon të shënojë rritje të qëndrueshme që nga tetori 2007, ku tani qëndron në 49%; shkalla e kënaqshmërisë me punën e Kuvendit të Kosovës po ashtu ka shënuar rritje (për 14 për qind), dhe tani është 52% (ilustrimi 1.1).

Shkalla më e lartë e kënaqshmërisë në mesin e të gjitha institucioneve të Kosovës vazhdon të jetë me sektorin e sigurisë si me KFOR-in, ashtu edhe me SHPK-në, ndër-


sa shkalla më e ulët e kënaqshmërisë i përket UNMIK-ut. Duhet ta keni parasysh se kjo është hera e parë që është përfshirë EULEX-i në pyetësor, ku me këtë rast ka arritur nivel të kënaqshmërisë prej 13%.

Që nga dhjetori 2007, shkalla e kënaqshmërisë me punën e kryetarit të Kosovës ka shënuar rritje të dukshme prej 14 për qind, dhe tani është 75%. Kënaqshmëria me punën e kryeministrit shënon nivelin prej 71%. Pasi që kënaqshmëria me punën e kryeministrit nuk është matur në dhjetor 2007, për shkak të zgjedhjeve të nëntorit dhe të ndryshimeve pasuese në qeveri, analiza e trendëve nuk është realisht e mundshme. Shkalla e kënaqshmërisë me gjykatat e Kosovës vazhdon të jetë shumë e ulët (vetëm 21%), gjë e cila është shqetësuese dhe i bën ata institucionin me renditje më të ulët në kuptim të shkallës së kënaqshmërisë.

Ilustrimi 1.2: Kënaqshmëria me punën e kryetarit, kryeministrit dhe të gjykatave të Kosovës



Ilustrimi 1.1: Kënaqshmëria me punën e institucioneve të Kosovës



Udhëheqja politike e Kosovës


Pesimizmi politik në Kosovë është rreth 39%, që paraqet vetëm dy për qind më pak se sa niveli i shënuar në dhjetor 2007, por larg nga niveli i më i lartë i shënuar në korrik 2002.

Shkallët e pesimizmit politik dhe të gatishmërisë për të protestuar për arsye politike në Kosovë vazhdojnë të jenë ndryshueshme (ilustrimi 1.3). Regjioni i Mitrovicës dhe ai i Prishtinës e ndajnë vendin e parë për kah niveli më i lartë i pesimizmit politik (mbi 50%), të pasuara nga regjioni i Ferizajt dhe Gjilanit (mbi 40%) dhe me Prizrenin, Pejën dhe Gjakovën (mbi 20%). Regjioni i Gjakovës me 23% tejkalon Prizrenin, i cili në dhjetor 2007 ishte regjioni me nivelin më të ulët të pesimizmit politik (33%). Edhe kësaj radhe regjioni i Mitrovicës vazhdon të jetë regjioni me nivelin më të lartë të pesimizmit politik (58%), gjë e cila mund të ndodh për disa arsye të ndryshme, duke përfshirë mes të tjerash, ndarjen etnike, mungesën e sigurisë, pamundësinë për tu kthyer në pronat në veri e kështu me rradhë. Mirëpo, është më pak e qartë arsyeja pse regjioni i Prishtinës ndodhet në vendin e dytë pas Mitrovicës në këtë aspekt.

Gjakova, me 79%, zë vendin e parë për nga gatishmëria e protestimit për arsye politike. Në anketën e dhjetorit 2007, Gjilani ishte në vendin e parë përkitazi me këtë tregues. Në bazë të anketës së majit 2008, pas Gjakovës sa i përket gatishmërisë për të protestuar për arsye politike vijnë Mitrovica, Prishtina, Ferizaj, Gjilani, Prizreni dhe Peja (me nivel më të ulët prej vetëm 31%).

Në krahasim me rezultatet e anketës së dhjetorit 2007, anketa e majit 2008 tregon një rënie të dukshme prej rreth 12 për qind në mbarë Kosovën të nivelit të gatishmërisë së protestimit për arsye politike. Tani për tani, ky tregues shënon 54%, gjë që paraqet ende një numër të madh të njerëzve të gatshëm të protestojmë për arsye politike. Duke marrë parasysh rënien e pesimizmit politik, do të pritej një rënie e ngjashme e gatishmërisë së protestimit për arsye politike, siç është treguar në rezultatet e anketës së majit 2008.

Ilustrimi 1.3: Niveli i pesimizmit politik dhe i protestave politike sipas regjionit




Mediat dhe shërbimet publike

Në krahasim me rezultatet e dhjetorit 2007, ato të majit 2008 tregojnë se mesatarisht numri i kosovarëve që i përcjellin çdo ditë lajmet nuk ka pësuar ndryshime të mëdha (një rënie prej 2 për qind, dhe tani është 66%), ndërsa për ata që i përcjellin lajmet vetëm herë pas here (një herë deri në katër herrë në javë), numri ka rënë për 14 për qind (tani është 27%). Sa i përket të anketuarve që kurrë nuk i përcjellin lajmet, kjo shifër qëndron në 6%.

Lidhur me saktësinë e informatave nga mediat, rreth 17% e të anketuarve u besojnë të gjitha informatave që i marrin, ndërsa 10% nuk i besojnë asnjë informate. Shumica e të anketuarve (65%) u besojnë vetëm pjesërisht informatave që i marrin nga mediat. Në krahasim me dhjetorin 2007, rezultatet e anketës së majit nuk tregojnë ndryshime të dukshme të këtyre treguesve.


Siç ishte rasti me anketën e dhjetorit 2007, anketa e fundit gjithashtu tregon se shumica e të anketuarve u besojnë vetëm disa informatave nga mediat parësisht prej shpeshësisë së përcjelljes së lajmeve. Janë ata që kanë tendencë të përcjelljes së lajmeve më shpesh që po ashtu kanë tendencë t'u besojnë të gjitha informatave që i marrin nga mediat, që do të thotë se numri i atyre që u besojnë të gjitha informatave bie me rënien e shpeshësisë së përcjelljes së lajmeve (ilustrimi 1.4). Megjithatë duhet të ceket, se ky raport është vetëm korrelacion dhe nuk dëshmon domosdo çfarëdo efekti shkakor.

ilustrimi 1.4: Shpeshhtësia e përcjelljes së lajmeve dhe e të besuarit në informatat nga mediat



Të grupura sipas moshës, rezultatet e anketës tregojnë se është popullata relativisht më e vjetër (46+ vjet) ajo që i përcjell më me përkushtim lajmet në Kosovë – 78% e kësaj grupmoshe i përcjellin çdo ditë lajmet aktuale në media (ilustrimi 1.5). Në mesin e atyre që i përcjellin lajmet çdo ditë në media, të rinjtë (18-24 vjeçar) përfaqësojnë grupin më të vogël, me rreth 52% (rënie prej 5 për qind që nga dhjetori 2007) e të anketuarve në këtë kategori.


ilustrimi 1.5: Shpeshhtësia e përcjelljes së lajmeve në media sipas grupmoshës



Sa i përket të besuarit në saktësinë e informatave, nuk është vërejtur ndonjë dallim i madh mes grupmoshave të ndryshme. Shumica e të anketuarve,

mesatarisht 65%, nga të gjitha grupmoshat, kanë tendencë t’u besojnë vetëm disa prej informatave që i marrin nga mediat. Në përgjithësi, tek të gjitha grupmoshat, më pak se 10% e të anketuarve nuk i besojnë asnjë informate nga mediat, përveç grupmoshës prej 31 deri në 36 vjet, shifra e të cilëve qëndron në 13% (ilustrimi 1.6).


ilustrimi 1.6: Grupmoshat dhe të besuarit në informatat e mediave



Kjo është anketa e tretë me rradhë që nga tetori 2007 që tregon se Radio Televizioni publik i Kosovës, RTK-ja, është shërbimi publik me të cilin më së shumti të anketuar (56%) janë të kënaqur (ilustrimi 1.7). Furnizimi me ujë dhe arsimiti ndanë vendin e dytë pas RTK-së, me shkallë të kënaqshmërisë prej rreth 47% të të anketuarve.

Kënaqshmëria me shërbimet e tjera publike, siç janë ato të postës dhe telekomunikacionit, të higjienës, të regjistrimit civil, të infrastrukturës dhe të kujdesit shëndetësor mbetet mjaft e ulët, gjë që paraqet tregues të qartë për nevojën e reformës së këtyre institucioneve me qëllim të rritjes së efektshmërisë dhe të kënaqshmërisë me punën e tyre.

Që nga tetori 2007, rryma elektrike vazhdon të mbetet shërbimi publik i renditur në vendin e fundit apo shërbimi publik, me të cilin njerëzit janë më së paku të kënaqur. Shkalla e kënaqshmërisë së të anketuarve me rrymën elektrike (Korporata Energjetike e Kosovës – KEK), pas rënies për 11.5 për qind që nga tetori, dhe të rënies prej gjashtë për qind mes korrikut dhe tetorit 2007, që nga dhjetori 2007 është rritur për pesë për qind dhe tani shënon 8% - që është shumë më ulët se cilido shërbim tjetër publik.



II. Përgjegjësia për gjendjen politike të Kosovës


Kush është përgjegjës?

Nga dhjetori 2006 deri në qershor 2007, është shënuar rënie e vazhdueshme në numrin e të anketuarve që i konsideronin IPVQ-të (tani Qeveria e Kosovës) përgjegjëse për gjendjen politike të Kosovës, ndërsa numri i atyre që e konsideronin UNMIK-un u rrit. Një trend i kundërt është vërejtur mes qershorit dhe dhjetorit 2007.


Lëvizja e këtyre treguesve (mes qershorit dhe dhjetorit 2007) nënkupton se dallimi mes atyre që i konsiderojnë IPVQ-të (tani Qeveria e Kosovës) përgjegjëse dhe i atyre që e konsiderojnë UNMIK-un përgjegjës për gjendjen politike në Kosovë është duke u ngushtuar. Mirëpo, anketa e majit 2008 tregon ndryshim të këtij trendi, me rritje të dallimit mes atyre që e konsiderojnë Qeverinë e Kosovës përgjegjëse dhe atyre që e konsiderojnë UNMIK-un përgjegjës për gjendjen politike në Kosovë – ngjashëm me trendin mes dhjetorit 2006 dhe qershorit 2007.

Numri i atyre që e konsiderojnë Qeverinë e Kosovës përgjegjëse për gjendjen politike në Kosovë ka shënuar rënie prej 16 për qind dhe është rritur për katër për qind numri i atyre që e konsiderojnë UNMIK-un përgjegjës për gjendjen politike në Kosovë (ilustrimi 1.8). Që nga dhjetori 2007, një numër dukshëm më i madh i kosovarëve e konsiderojnë UNMIK-un përgjegjës për gjendjen politike, në krahasim me ata që i konsiderojnë IPVQ-të (tani Qeveria e Kosovës) përgjegjëse për të njëjtën. Duke marrë parasysh të gjitha zhvillimet e rëndësishme politike që ndodhen në Kosovë mes dhjetorit 2007 dhe majit 2008 – siç është shpallja e pavarësisë, miratimi i Kushtetutës së Kosovës e kështu me rradhë – nuk do të ishte e paarsyeshme të supozohet se më shumë njerëz do t'i shihnin IPVQ-të (tani Qeveria e Kosovës) si kryesisht

më të përgjegjshmet për gjendjen politike në Kosovë. Megjithatë, rezultatet e anketës së majit tregojnë të kundërtën. Sidoqoftë, mund të pritet që ky trend do të ndryshojë pas 15 qershorit 2008, me hyrjen në fuqi të Kushtetutës së Kosovës, ku Qeveria e Kosovës do t'i marrë plotësisht të gjitha përgjegjësitë e qeverisjes.



Madje edhe në bazë të rezultateve të anketës së majit 2008, mbetet fakti se një numër më i madh i kosovarëve ende e konsiderojnë UNMIK-un më shumë përgjegjës për gjendjen politike të Kosovës në krahasim me ata që e konsiderojnë Qeverinë e Kosovës. Kështu ndodh në të gjitha regjionet kryesore të Kosovës (ilustrimi 1.9).




Protestat për arsye politike

Në anketën e tetorit 2007 është shënuar rritje e madhe prej rreth 30 për qind (mesatarisht) tek të gjitha etnitë përkitazi me gatishmërinë e protestimit për arsye politike. Përderisa kjo shifër është konfirmuar prapë përmes rezultateve të anketës së dhjetorit 2007, re-

zultatet e anketës së majit 2008 tregojnë rënie të dukshme në gatishmërinë e shqiptarëve dhe pakicave të tjera që të protestojnë për arsye politike. Numri i shqiptarëve ka rënë për 12 për qind, ndërsa numri i pakicave të tjera ka rënë për 13 për qind.

Mirëpo, sa u përket serbëve, gatishmëria e tyre për të protestuar për arsye politike mes dhjetorit 2007 dhe majit 2008 është rritur për 16 për qind. Kjo rritje kryesisht mund të ketë ndodhur për shkak të shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe përfundimit të procesit të statusit përfundimtar. Të njëjta arsye mund të kenë ndikuar te të anketuarit shqiptarë dhe të tjerë që të zvogëlohet gatishmëria e tyre e protestimit për arsye politike.

Tani për tani, rreth 86% e serbëve, 46% e shqiptarëve dhe 33% e të anketuarve të tjerë do të protestonin për arsye politike (ilustrimi 1.10). Që nga tetori 2007, serbët vazhdojnë të jenë grupi më i gatshëm të protestojnë për arsye politike.



III. Kosova e passtatusit

Shpallja e shtetësisë së Kosovës

Më 17 shkurt 2008, Kuvendi i Kosovës deklaroi pavarësinë e Kosovës përmes një Deklarate të Pavarësisë që u miratua nga shumica e deputetëve të Kuvendit. Deklarata e Pavarësisë së Kosovës u miratua pas disa vite negociatash mes Prishtinës dhe Beogradit lidhur me statusin e saj përfundimtar. Kjo shpallje e pavarësisë morri parasysh dokumentin gjithëpërfshirës të Ahtisarit për zgjidhjen e statusit përfundimtar, i cili njihet botërisht si Plani i Ahtisarit apo Pakoja e Ahtisarit, që ia ofron një vister të gjerë të të drejtave dhe të pushtetit vetëqeverisës pakicës së serbëve të Kosovës.

Përkundër faktit se statusi përfundimtar tani më është përcaktuar, Kosova vazhdon të ballafaqohet me shumë pengesa, për të cilat njerëzit mendojnë se e kërcënojnë stabilitetin e saj.


Kur u pyetën për rrethanat që kërcënojnë stabilitetin e Kosovës, papunësia dhe varfëria janë theksuar nga shqiptarët dhe të anketuarit e pakicave të tjera si faktorë kryesorë.

Për të anketuarit serbë, përkeqësimi i mëtejshëm i marrëdhënieve ndëretnike paraqet faktorin kryesor, që e kërcënon stabilitetin e Kosovës, i cili pasohet me mungesën e sundimit të ligjit (tabela 1.1).


Tabela 1.1: Mendimi për rrethanat që e kërcënojnë stabilitetin e Kosovës

	Përkatësia etnike			
	Shqiptarë	Serbë	Të tjerë	Gjithsej e ponderuar
1. Përkeqësimi i mëtejshëm i marrëdhënieve ndëretnike	4.1%	57.0%	19.1%	8.19%
2. Papunësia dhe varfëria	68.9%	1.5%	70.3%	64.92%
3. Përkeqësimi i marrëdhënieve me vendet fqinje	1.4%	1.5%	.4%	1.32%
4. Përkeqësimi i marrëdhënieve me bashkësinë ndërkombëtare	3.4%	12.5%	2.5%	3.92%
5. Radikalizimi fetar	.6%		.4%	0.53%
6. Radikalizimi politik	.2%	2.5%	.4%	0.38%
7. Mungesa e sundimit të ligjit	9.4%	19.0%	3.8%	9.63%
8. Korrupsioni dhe keqmenaxhimi	10.4%	3.0%	1.3%	9.42%
Të tjera?	.3%			0.30%
Nuk e di / pa përgjigje	1.3%	3.0%	1.7%	1.39%
Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Sa i përket mënyrës se si është menaxhuar shpallja e pavarësisë së Kosovës, shumica dërrmuese e të anketuarve shqiptarë dhe e pakicave të tjera kanë qenë të kënaqur, ndërsa shumica e serbëve kanë qenë të pakënaqur. Rreth 89% e shqiptarëve dhe 79% e të anketuarve të tjerë kanë qenë të kënaqur apo shumë të kënaqur, ndërsa vetëm 3% e shqiptarëve dhe mbi 92% e serbëve kanë qenë të pakënaqur apo shumë të pakënaqur (ilustrimi 1.11).




Pyetësi i anketës së majit 2008, gjithashtu përfshinte pyetjet se kush mendonin se kishte merita më të mëdha për pavarësinë e Kosovës. Mi 40% e të anketuarve thanë se merita më e madhe i takonte popullit të Kosovës, që pasojë me SHBA-të (28%) dhe me UÇK-në (18%). Bashkimi Evropian (BE) dhe Kombet e Bashkuara (KB) janë shumë më prapa se SHBA-ja, me përkatësi të vetëm 2% dhe 1% e të anketuarve që u dhanë meritat atyre për pavarësinë e Kosovës.




Në ditën kur Kosova e shpalli pavarësinë e saj, Kuvendi i Kosovës gjithashtu miratoi flamurin e ri shtetëror të Kosovës. Megjithatë, vetëm 56% e kosovarëve ishin të shumë të kënaqur apo të kënaqur me mënyrën se si ka lindur flamuri shtetëror i Kosovës, ndërsa rreth 18% ishin të pakënaqur apo shumë të pakënaqur me këtë proces. Rreth 17% e kosovarëve as që kanë qenë të kënaqur e as të pakënaqur me procesin.

Sipas regjioneve, Gjakova, Peja dhe Prizreni udhëheqin me mbi 70% e njerëzve që janë deklaruar si të kënaqur (shumë të kënaqur dhe të kënaqur) me mënyrën sesi ka lindur flamuri shtetëror i Kosovës; në krahasim me Prishtinën dhe Mitrovicën, ku më pak se 40% e njerëzve kanë qenë të kënaqur apo shumë të kënaqur.




Përveç kësaj, përderisa flamuri i ri shtetëror ka për qëllim përfaqësimin e të gjitha etnive që jetojnë në Kosovë përmes gjashtë yjeve të tij (ku secili përfaqëson një përkatësi etnike kryesore), rezultatet e anketës së majit 2008 tregojnë se asnjë nga të anketuarit serbë nuk ndihen të përfaqësuar mirë nga flamuri i ri shtetëror i Kosovës. Ky është një tregues i qartë se forma e flamurit të ri shtetëror nuk i ka kënaqur serbët, edhe përkundër faktit se nuk ka përfshirë asnjë simbol shqiptar apo ngjyrat e flamurit kombëtar shqiptar.



Megjithatë, rreth 74% e të anketuarve shqiptarë dhe 91% e pakicave të tjera ndjehen mirë të përfaqësuar me flamurin e ri shtetëror, përderisa vetëm 12% e shqiptarëve, 2% e të tjerëve dhe rreth 70% e serbëve nuk ndihen mirë të përfaqësuar me flamurin shtetëror (ilustrimi 1.13).

Në prill të vitit 2008, Kuvendi i Kosovës miratoi një dokument tjetër themelor për shtetin e ri – Kushtetutën e tij. Siç mund të shihet nga raportet e medieve (të bashkangjitura në fund të raportit), përmbajtja e Projekt Kushtetutës është debatuar gjerë e gjatë në shoqërinë e Kosovës.

Kur u pyetën lidhur me procesin e krijimit të Kushtetutës së re të Kosovës, përafërsisht 36% e të anketuarve shqiptarë dhe 43% e të tjerëve deklaruan se ishin të kënaqur apo shumë të kënaqur me procesin. Përderisa rreth 23% e shqiptarëve, 49% e serbëve dhe 13% e të tjerëve deklaruan se ishin të pakënaqur apo shumë të pakënaqur me procesin, ndërsa rreth 31% e shqiptarëve dhe 35% e të tjerëve thanë se nuk ishin as të kënaqur e as të pakënaqur me procesin (ilustrimi 1.14).



Edhe pse Komisioni Kushtetues, i cili ishte përgjegjës për hartimin e Kushtetutës dhe diskutimin e saj me qytetarët në mbarë Kosovë, organizoi një fushatë të informimit publik dhe të marrjes së opinioneve nga qytetarët, shumica e kosovarëve nuk e kanë lexuar Projektkushtetutën fare.

Në bazë të rezultateve të anketës së majit 2008, mbi 82% e shqiptarëve, 90% e serbëve dhe 91% e të tjerëve deklaruan se nuk e kanë lexuar Projektkushtetutën e Kosovës fare (ilustrimi 1.15).





Tabela 1.2: A do t'i bashkoheshit një partie të re politike në Kosovë që do të themelohej nga profesionistët e rinj – kosovarët që kanë studiuar jashtë dhe që kurrë më parë nuk kanë qenë të përfshirë në politikë në Kosovë?

	REGJIONI							
	Prishtinë	Mitrovicë	Prizren	Pejë	Ferizaj	Gjakova	Gjilan	Gjithsej
Po	29.5%	12.1%	33.5%	21.4%	40.8%	62.9%	34.5%	30.3%
Jo	45.3%	38.9%	44.9%	38.3%	20.8%	12.9%	33.8%	38.0%
Nuk e di	20.1%	27.4%	19.5%	33.8%	32.3%	21.4%	24.1%	24.4%
PP	5.2%	21.6%	2.2%	6.5%	6.2%	2.9%	7.6%	7.3%
Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%



Preferencat politike dhe qeveria


Një pjesë mjaft e madhe e kosovarëve vazhdojnë të mbesin pa preferenca politike, ku rreth 17% e të anketuarve thonë se nuk kanë preferenca politike për asnjërin prej partive ekzistuese, ndërsa 25% të tjerë thjeshtë dëshirojnë të rrinë plotësisht larg politikës. Megjithatë, rreth 43% e të anketuarve deklaruan se kanë preferenca politike për njërin nga partitë e Kosovës (ilustrimi 1.16).

Kur të anketuarit u pyetën nëse do t'i bashkoheshin ndonjë partie të re politike në Kosovë, të themeluar nga kosovarët që kanë studiuar jashtë vendit dhe që nuk kanë qenë kurrë më parë të përfshirë në politikë në Kosovë, rreth 30% u përgjigjën pozitivisht në krahasim me 38% të cilët u përgjigjën negativisht. Rreth 24% e të anketuarve thjesht nuk u përgjigjën (tabela 1.2).

Në aspektin regjional, rezultatet e anketës tregojnë se Gjakova është vendi ku më së shumti njerëz (rreth 63%) do t'i bashkoheshin një partie, në krahasim me Mitrovicën ku më së paku njerëz (12%) do ta bënin një gjë të tillë.


Zgjedhjet e nëntorit të vitit 2007 rezultuan me një qeveri të koalicionit mes dy kundërshtarëve të vjetër politikë – PDK-së (Partia Demokratike e Kosovës) dhe LDK-së (Lidhja Demokratike e Kosovës).

Në Kosovë, rreth 55% e të anketuarve janë optimist rreth mundësisë së kësaj qeverie të koalicionit që të punojë në dobi të tyre kundrejt 36% e atyre që janë pesimist.



Kur u pyetën për mendimin rreth koalicionit rreth PDK-LDK, përafërsisht 18% e të anketuarve shqiptarë thanë se mendonin se ishte koalicion i drejtë politik, derisa rreth 21% menduan se nuk ishte i drejtë politikisht. Rreth 41% e shqiptarëve menduan se koalicionin ishte i drejtë vetëm deri në një mase. Në mesin e popullatës serbe, rreth 15% menduan se ky koalicion nuk ishte politikisht i drejtë, ndërsa rreth 56% e të tjerëve menduan se ky koalicion ishte i drejtë politikisht dhe deri në një masë i drejtë.

Nga aspekti regional, Gjakova (77%) dhe Prizreni (71%) udhëheqin me më së shumti optimistë lidhur me mundësinë e qeverisë së re të koalicionit që të punojë në dobi të tyre, në krahasim me Mitrovicën (40%) dhe Prishtinën (45%) me më së paku të anketuar që dolën të jenë optimistë (ilustrimi 1.18).



IV. Përfundimet e Grupit të ekspertëve mbi çështjet e stabilitetit institucional dhe politik

Në bazë të Grupit të ekspertëve që u mblodh për të diskutuar rezultatet e anketës së SPH-së, trendet brengosëse që kërkojnë vëmendje të posaçme janë si në vijim:

- Përderisa ka pasur një rënie, përqindja e të anketuarve që do t'u bashkoheshin protestave për shkak të gjendjes politike ende mbetet relativisht i lart.
- Mbi një të treta e të anketuarve janë pesimistë lidhur me aftësinë e qeverisë së re të koalicionit që të punojë në dobi të tyre.
- Numri i vogël i njerëzve që i besojnë informatave nga mediat.
- Dallimet e vazhduara dhe të mëdha mes shqiptarëve dhe serbëve për atë se çka e kërcënon stabilitetin e Kosovës (gjegjësisht, papunësia dhe varfëria për shqiptarët dhe mungesa e sundimit të ligjit për serbët).
- Numri shumë i vogël i serbëve që janë të kënaqur me flamurin e ri shtetëror të Kosovës, i cili është paraparë t'i kënaq të gjitha etnitë.
- Numri shumë i lartë i njerëzve që kurrë nuk e kanë lexuar Projekt Kushtetutën e Kosovës.
- Numri relativisht i lartë i njerëzve që nuk janë të kënaqur me punën e pushtetit lokal të tyre.

Sa i përket elementeve që i kontribuojnë jostabilitetit institucional dhe politik, grupi i ekspertëve ka identifikuar faktorët vijues:

- Vazhdimi i pritjeve të larta përkitazi me zhvillimet pozitive, siç janë pritjet lidhur me njohjen e pavarësisë së Kosovës nga shumë më shumë vende sesa që e kanë bërë këtë deri më tani.
- Në bazë të grupit të ekspertëve, një problem i madh lidhur me stabilitetin politik është se çështjet sociale, gjinore dhe të rinisë vazhdojnë të mos shtjellohen në debatet politike në Kosovë.
- Prania e vazhdueshme e strukturave paralele serbe në Kosovë, që e pengojnë përfshirjen dhe pjesëmarrjen e serbëve në shoqërinë e Kosovës.
- Mosfrimi i mjaftueshëm i argumenteve dhe i fakteve substanciale nga mediat në raportimet e tyre, që kontribuon në mungesën e besimit të popullit ndaj mediave.

- Mungesa e aplikimit të Ligjit për qasje në dokumentet publike për shkak të klasifikimit të shumë dokumenteve si "jo të hapura për publikun".
- Incidentet e dhunshme të marsit në Mitrovicë kanë ndikuar negativisht në marrëdhëniet ndëretnike dhe kanë zvogëluar kënaqshmërinë e serbëve me institucionet e sigurisë të Kosovës.

Skenarët e mundshëm alarmues të identifikuar nga Grupi i ekspertëve:

- Mungesa e debatit politik për çështjet gjinore, të të rinjve dhe për çështjet e përgjithshme, mund që gjatë një afati më të gjatë të krijojë grupe të marginalizuara, të cilat do të përpiqen ta shfaqin pakënaqësinë e tyre jashtë sistemit, që rrjedhimisht ka potencial të çojë në destabilizim politik dhe në protesta.
- Mosndërlidhja e vazhdueshme e perceptuar mes rasteve të korrupsionit të raportuara në media dhe veprimeve ligjore kundër korrupsionit krijon pakënaqësinë dhe mosbesim ndaj institucioneve dhe rritë përkrahjen për organizatat që kërkojnë zgjidhje jashtë sistemit.
- Krijimi i tjetërsimit dhe anemoziteteve drejt vendeve të BE-së si rezultat i pengesave ndaj lirisë së lëvizjes, siç janë proceset e komplikuar të nxjerrjes së vizave, të cilat ndikohen edhe më tej nga mospërfshirja e Kosovës në "Ligjin e liberalizimit" mbi kushtet e marrjes së vizës së BE-së për qytetarët e vendeve të Ballkanit perëndimor.
- Mosndërlidhja mes premtimeve të bëra para pavarësisë dhe realitetit pas pavarësisë – që shumë vite me rradhë, IPVQ-të (tani Qeveria e Kosovës) kanë fajësuar mungesën e shtetësisë për shumë probleme, dhe tani ky argument nuk vlen më.

Për t'i trajtuar çështje që ndikojnë në stabilitetin politik dhe institucional, Grupi i ekspertëve rekomandon veprimet vijuese:

- Institucionet dhe, në veçanti, Zyra e Prokurorit, duhet të jenë më të ndjeshme ndaj raportimit të mediave, e veçanërisht ndaj raportit të Auditorit të përgjithshëm. Ajo së paku duhet të fillojë hetimet paraprake ndaj rasteve që debatohen gjerë e gjatë në media. Kjo do të ndihmonte në rritjen e besimit në institucionet relevante, dhe në rastet ku pohimet dëshmojnë të jenë të pasakta, do të ofrojë dëshmi publike se jo "gjithçka është e korrupsuar".

- Partitë politike dhe Qeveria e Kosovës duhet të krijojnë mekanizma për pjesëmarrjen e femrave dhe të rinisë në vendimmarrje, qoftë duke ua dhënë një numër të caktuar vendesh në këshillat udhëheqëse të partive rinisë dhe femrave apo duke ofruar qase të drejtpërdrejta këtyre grupeve në këshillat politike të partive.
- Qeveria e Kosovës dhe, në veçanti, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Drejtësisë duhet ta marrin më seriozisht çështjen e liberalizimit të vizave, duke u përpjekur t'i plotësojë kërkesat për Partneritetin Evropian, që mund të çojë tërthorazi në marrëveshje për përfshirjen e Kosovës në procesin e liberalizimit të vizave brenda BE-së, posaçërisht tani kur Kosova është e pavarur.
- Të gjitha mediat duhet të raportojnë më shumë duke u bazuar në fakte, ku kjo kërkon që Qeveria e Kosovës t'u ofrojë mediave qasje më të mirë në dokumente të qeverisë. Zbatimi i plotë i Ligjit për qasje në dokumente publike dhe publikimi i procedurave mbi klasifikimin e dokumenteve (siç janë ato të hapura për publikun dhe të mbyllura për të) duhet të ndërmerret menjëherë.

Kapitulli 2

STABILITETI EKONOMIK DHE SOCIAL I KOSOVËS

I. Një pasqyrë e përgjithshme ekonomike

Deri në dhjetor 2007, shumica e të anketuarve në përgjithësi kanë theksuar se paqartësia lidhur me statusin përfundimtar të Kosovës ka paraqitur problemin madhor me të cilin përballet Kosova. Në dhjetor 2007, 32% e të anketuarve kanë menduar se pasiguria lidhur me statusin përfundimtar të Kosovës ishte problemi madhor, pastaj papunësia (17%) dhe varfëria (15%).

Tani, me përcaktimin e statusit përfundimtar, rezultatet e anketës së bërë në maj 2008 paraqesin se problemi madhor me të cilin përballet Kosova është


papunësia (përzgjedhur nga 32% e të anketuarve), pastaj varfëria (23%) dhe mungesa e energjisë elektrike (10%).

Sipas rezultateve të anketës së tanishme të paraqitura në tabelën 2.1, kosovarët tani qartësisht e shohin mungesën e zhvillimit ekonomik (përfaqësuar nga papunësia dhe varfëria e lartë) si problemin madhor me të cilin përballet Kosova.

Në përgjithësi, kosovarët vazhdojnë të jenë shumë të pakënaqur me mundësitë aktuale të punësimit. Sipas rezultateve të anketës së majit 2008, pesimizmi i lidhur me punësimin tani është 67% (një rënie prej katër për qind që nga dhjetori 2007), përderisa pesimizmi i lidhur me punësimin – për të ardhmen është 31% (pa ndonjë ndryshim domethënës që nga dhjetori 2007). Ndonëse ky pesimizëm mbetet relativisht i lartë, fakti që nga tetori 2007 është parë një rënie e këtij pesimizmi është disi premtues.

Table 2.1: The paramount problem facing Kosovo

	RAJONET							
	Prishtinë	Mitrovicë	Prizren	Pejë	Ferizaj	Gjakovë	Gjilan	Gjithsej
Infrastruktura rrugore	.6%		1.5%	3.9%	.8%	1.4%		1.1%
Furnizimi me energji elektrike	7.2%	3.2%	8.1%	14.3%	16.9%	20.0%	11.7%	9.8%
Probleme me hapësirë urbane (ndërtime të egra)	.3%	.5%	.7%					.3%
Ndotja e mjedisit	.6%	.5%	.4%	.6%		1.4%		.5%
Varfëria	26.1%	17.4%	30.1%	16.2%	16.2%	28.6%	17.2%	22.7%
Çmimet	6.6%	6.3%	3.7%	17.5%	6.2%	7.1%	6.9%	7.3%
Shërbimet shëndetësore	1.7%	.5%	.7%	1.3%	3.1%	1.4%		1.2%
Siguria publike dhe personale	8.9%	14.7%	1.1%	.6%	5.4%		8.3%	6.3%
Arsimi	.3%	.5%	.4%		.8%	4.3%	2.1%	.8%
Marrëdhëniet ndëretnike	5.4%	11.1%	.4%	3.9%			3.4%	4.0%
Papunësia	22.6%	25.8%	44.1%	33.1%	35.4%	32.9%	36.6%	32.1%
Pasiguria lidhur me statusin përfundimtar të Kosovës	6.9%	10.5%	.4%		.8%		4.8%	4.0%
Rezultatet e padëshirueshme nga statusi përfundimtar	1.1%	.5%	3.7%	.6%	.8%			1.3%
Problemet sociale (pensionet, invalidët, bonjakët etj)	.3%	1.6%	1.1%	2.6%	2.3%		.7%	1.1%
Fati i personave të pagjetur	6.0%			.6%	4.6%		1.4%	2.3%
Krimi i organizuar	.3%	.5%		.6%	.8%		1.4%	.5%
Rastet e pazgjidhura të vrasjeve	2.9%	3.7%	2.6%	1.3%	2.3%	2.9%	4.1%	2.8%
Korrupsioni		.5%		1.9%			.7%	.4%
Sjellja asociale (prostitucioni, droga, alkoolizmi, trafikimi)	1.4%		.7%		3.1%			.8%
Nuk ka përgjigje	.9%	2.1%	.4%	.6%	.8%		.7%	.8%
Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%




Kënaqshmëria e të anketuarve shqiptarë me gjendjen ekonomike të familjeve të tyre ka shënuar një rënie të vogël prej katër për qind mes dhjetorit 2007 dhe majit 2009, pas një trendi në ngritje që nga periudha raportuese prill – qershor 2007.

Në anën tjetër, pas një ngritjeje prej pesë për qind mes tetorit dhe dhjetorit 2007, rezultatet e anketës së tanishme tregojnë një ngritje të vogël prej dy për qind të kënaqshmërisë së të anketuarve nga pakicat e tjera me gjendjen ekonomike të familjeve të tyre.

Ndërsa, për sa i përket kënaqshmërisë së serbëve lidhur me gjendjen ekonomike të familjeve të tyre, kjo ka pësuar një rënie prej tetë për qind që nga dhjetori 2007.

Për të gjithë kosovarët, kënaqshmëria me gjendjen ekonomike të familjeve të tyre mbetet në nivel dukshëm të ulët – me 18% për shqiptarët, 8% për serbët dhe 14% për pakicat e tjera (ilustrimi 2.2).



Nëse i shikojmë ndryshimet e të ardhurave familjare krahasuar me vitin e kaluar, në mesin e të gjitha etnive, shumica e të anketuarve kanë theksuar se të ardhurat e tyre familjare kanë mbetur të njëjta (57%). Për rreth 9% të shqiptarëve, rreth 16.5% të serbëve dhe diku 8% të pakicave të tjera, të ardhurat familjare kanë shënuar një ngritje të vogël (tabela 2.2). Në anën tjetër, 22% e shqiptarëve, 12.5% e serbëve dhe 34% e pakicave të tjera kanë përjetuar një rënie në të ardhurat familjare. Ndryshime të dukshme pozitive në të ardhurat familjare duket t’u kenë ndodhur vetëm 1% të shqiptarëve dhe 1% të serbëve, ndërsa ndryshime të dukshme negative duket t’u kenë ndodhur rreth 11% të shqiptarëve, 5% të serbëve dhe rreth 6% të pakicave të tjera. Andaj, sikurse në dhjetor 2007, në përgjithësi nëse ka patur ndryshime në të ardhurat familjare për kosovarët, ndryshimet e tilla në përgjithësi kanë qenë më shumë negative sesa pozitive.

Tabela 2.2: Ndryshimet në të ardhurat familjare krahasuar me vitin e kaluar

	Përkatësia etnike			
	Shqiptarë	Serbë	Të tjerë	Gjithsej
Janë ngritur dukshëm	.9%	1.0%		.8%
Janë ngritur pak	9.4%	16.5%	7.6%	10.2%
Kanë mbetur të njëjta	56.3%	65.0%	52.1%	56.9%
Kanë rënë pak	22.4%	12.5%	34.3%	23.1%
Kanë rënë dukshëm	11.0%	5.0%	5.9%	9.2%
Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Sipas rezultateve të anketës së majit 2008, shumica dërmuese e kosovarëve të të gjitha etnive (84%) nuk kanë humbur punën e as nuk janë punësuar gjatë gjashtë muajve të fundit, siç mund të shihet në tabelën 2.3. Megjithatë duhet të theksohet se vetëm 6% e shqiptarëve, 9.5% (një ngritje prej tre për qind që nga dhjetori 2007) e serbëve dhe 3% e pakicave të tjera (një rënie prej tre për qind që nga dhjetori 2007) kanë gjetur punë në gjashtë muajt e fundit, përderisa rreth 4% (një rënie prej tre për qind që nga dhjetori 2007) e shqiptarëve, 9.5% (një ngritje prej pesë për qind që nga dhjetori 2007) e serbëve dhe 5% e pakicave të tjera kanë humbur punën në gjashtë muajt e fundit. Krahasuar me anketën e muajit dhjetor 2007, rezultatet e anketës së majit 2008 tregojnë një përkeqësim të vogël të gjendjes së punësimit në mesin e serbëve dhe një përmirësim të vogël në mesin e shqiptarëve. Megjithatë, ky është një indikacion i fuqishëm i një ekonomie të stagnuar ku perspektiva e punës dhe zhvillimi ekonomik ende duken mjaft larg për shumicën e kosovarëve.

Tabela 2.3: Ndryshimet në punësim brenda familjes në gjashtë muajt e fundit

	Çfarë përkatësie etnike i përkisni/çfarë grupi i përkisni?			
	Shqiptarë	Serbët	Të tjerë	Gjithsej
1. Punësohen	5.7%	9.5%	3.4%	5.9%
2. Humbin punën	4.1%	9.5%	5.1%	5.1%
3. Të dyja	2.5%	5.5%	.4%	2.6%
4. Asnjërin	86.0%	70.5%	90.3%	84.4%
8. Nuk di	.6%	4.0%	.8%	1.1%
9. Nuk përgjigjen	1.0%	1.0%		.8%
Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Për sa i përket veprimtarisë së biznesit në gjashtë muajt e fundit, shumica dërmuese e kosovarëve të të gjitha etnive (92%) nuk kanë hapur e as mbyllur ndonjë biznes (tabela 2.4). Vetëm rreth 2% e shqiptarëve, 3.5% e serbëve dhe 1% e pakicave të tjera kanë theksuar se kanë filluar biznes të ri në periudhën prej dhjetorit 2007 deri maj 2008, përdërisa rreth 1% e shqiptarëve, 1% e serbëve dhe 1% e pakicave të tjera kanë mbyllur ndonjë biznes brenda periudhës raportuese.

Tabela 2.4: Veprimtaria e biznesit në gjashtë muajt e fundit

	Përkatësia etnike			
	Shqiptarë	Serbë	Të tjerë	Gjithsej
Kanë filluar biznes [dyqan, fabrikë]	2.2%	3.5%	1.3%	2.2%
Kanë mbyllur biznes	1.4%	1.0%	.8%	1.2%
Të dyja	1.0%	6.0%	.8%	1.8%
Asnjërin	93.1%	83.0%	97.0%	92.3%
Tjetër	.3%			.2%
Nuk di	1.3%	3.0%		1.3%
Pa përgjigje	.7%	3.5%		1.0%
Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Një arsye e rëndësishme për mungesën e veprimtarisë biznesore duket të jetë perceptimi në mesën e të anketuarve se Kosova nuk ofron kushte të favorshme për fillim dhe funksionim të një biznesi. Rreth 48.5% e kosovarëve të të gjitha etnive, përkundër 27% në dhjetor 2007, besojnë se kushtet e tanishme për biznes janë të pafavorshme (tabela 2.5). Rreth 24% e kosovarëve besojnë se kushtet për biznes nuk janë as të favorshme e as të pafavorshme kundrejt 36.5% në dhjetor 2007. Gjithashtu, është shënuar një rënie domethënëse që nga dhjetori 2007 (prej 20% në vetëm 6%) e të anketuarve që raportojnë se këto kushte janë të favorshme.

Tabela 2.5: Vlerësimi i kushteve të tanishme të biznesit

	Çfarë përkatësie etnike i përkisni/çfarë grupi i përkisni?			
	Shqiptarët	Serbët	Të tjerë	Gjithsej
Të pafavorshme	43.2%	66.5%	53.0%	48.5%
As të favorshme e as të pafavorshme	23.5%	16.5%	30.5%	23.7%
Të favorshme	8.1%	.5%	3.8%	6.2%
Nuk di	23.7%	12.5%	12.3%	19.9%
Nuk ka përgjigje	1.5%	4.0%	.4%	1.7%
Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

II. Përgjegjësia për gjendjen ekonomike dhe mundësia e protestave për shkak të arsyeve ekonomike

Para se të shikohet se kush identifikohet nga të anketuarit si përgjegjës për gjendjen ekonomike të Kosovës, është e rëndësishme që t'i hidhet një vështrim kënaqshmërisë së kosovarëve me mënyrën e shpenzimit të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës (BKK) sipas anketës së majit 2008. Në përgjithësi, gati gjysma e kosovarëve (44% kundrejt 57% në dhjetor 2007) të të gjitha etnive janë të pakënaqur apo shumë të pakënaqur me mënyrën e shpenzimit të BKK-së (tabela 2.6).


Vetëm rreth 9% e shqiptarëve, pothuajse asnjë serb dhe 19.5% e pakicave të tjera janë të kënaqur apo shumë të kënaqur me shpenzimin e BKK-së, ndërsa rreth 50% e shqiptarëve (kundrejt 72% në dhjetor 2007), 36% (kundrejt 34% në dhjetor 2007) të serbëve dhe 30% (kundrejt 63% në dhjetor 2007) të pakicave të tjera janë të pakënaqur apo shumë të pakënaqur me shpenzimin e BKK-së. Këto shifra vazhdojnë të jenë një indikacion i fuqishëm që BKK-ja mund të ndahet për çështje dhe veprimtari që jo domosdo i përshtaten nevojave të shumicës së kosovarëve.

Tabela 2.6: Kënaqshmëria me mënyrën e shpenzimit të BKK-së

	Përkatësia etnike			
	Shqiptarë	Serbë	Të tjerë	Gjithsej
Shumë të kënaqur	.2%		1.7%	.5%
Të kënaqur	8.6%	.5%	17.8%	9.0%
Neutral	32.7%	.5%	30.5%	27.4%
Të pakënaqur	33.4%	17.5%	17.8%	28.2%
Shumë të pakënaqur	16.2%	18.5%	12.3%	15.9%
Nuk di	8.0%	36.5%	16.5%	13.9%
Nuk ka përgjigje	.8%	26.5%	3.4%	5.2%
Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Për sa i përket perceptimit të përgjegjësisë për gjendjen ekonomike të Kosovës, shumica e të anketuarve (56%) besojnë se Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes janë më së shumti përgjegjëse. Atribuimi i përgjegjësisë tek Qeveria e Kosovës ka shënuar një rënie të vogël për rreth katër për qind që nga anketa e dhjetorit 2007 kur ishte 60%.

Rezultatet e anketës së muajit maj 2008 tregojnë se numri i të anketuarve që mendojnë se UNMIK-u është përgjegjësi kryesor për gjendjen ekonomike të Kosovës është ngritur në 44% nga 40% në anketën e mëparshme të dhjetorit 2007. Megjithatë, IPVQ-të (tani Qeveria e Kosovës), edhe nëpër rajone, përveç në Mitrovicë, ende mendohen të jenë më së shumti përgjegjëse për kushtet ekonomike në Kosovë (ilustrimi 2.3).




Gatishmëria e kosovarëve për të protestuar për shkaqe ekonomike mbetet relativisht e lartë, edhe pse shifrat kanë shënuar një rënie të vogël në krahasim me anketën e dhjetorit 2007. Sipas rezultateve të anketës së majit 2008, rreth 70% (kundrejt 78% në dhjetor 2007) të kosovarëve janë të gatshëm të protestojnë për arsye ekonomike, që është dukshëm më e lartë sesa gatishmëria e tyre për të protestuar për arsye politike (rreth 46%).


Kjo shifër vazhdon të jetë një tregues shumë domethënës i brishtësisë së qetësisë që aktualisht është e pranishme në Kosovë, në veçanti kur kihet parasysh trendi i gatishmërisë për të protestuar për arsye ekonomike që nga dhjetori 2006 për shqiptarët dhe pakicat e tjera, dhe që nga qershori 2007 për serbët (ilustrimi 2.4). Aktualisht, rreth 60% e të anketuarve serbë dhe 48% e pakicave të tjera gjithashtu do të protestonin për arsye ekonomike.

Siç shihet në fillim të këtij kapitulli, mungesa e prosperitetit ekonomik është një nga problemet madhore me të cilin sot përballlet Kosova. Anketa e tanishme, sikurse anketa e dhjetorit 2007, tregon që ky prob-


lem mbështetet edhe nga fakti që shumë kosovarë të cilët ndihen të brenjosur apo të shqetësuar gjatë ditës, ndihen kështu për shkak të arsyeve ekonomike. Vetëm rreth 10%, sikurse në dhjetor 2007, të të gjithë




kosovarëve kanë raportuar se ata nuk ndihen të brenjosur apo të shqetësuar gjatë ditës, ndërsa rreth gjysma kanë raportuar që nganjëherë ndihen të brenjosur apo të shqetësuar gjatë ditës, dhe rreth 43% kanë raportuar të ndihen të brenjosur apo të shqetësuar pothuajse gjithnjë (ilustrimi 2.5).




Rezultatet e anketës së muajit maj 2008, sikurse dy anketat e mëparshme të tetorit dhe dhjetorit 2007, vërtetojnë se burimet kyçe të brenjosjes dhe shqetësimit dallojnë sipas përkatësisë etnike. Për shqiptarët dhe pakicat e tjera arsyet kyçe për brenjosjen e tyre është ekonomia, ndërsa për serbët është siguria (ilustrimi 2.6).



Veç kësaj, Ilustrimi 2.7 dëshmon se kosovarët në përgjithësi besojnë se ata mund të kenë ndikim mbi drejtimin e jetës së tyre vetëm deri në një nivel të caktuar. Përderisa shumica e të anketuarve të të gjitha grupmoshave ndihen në këtë mënyrë, ekziston një trend në rënie e sipër në mesin e grupmoshave më të vjetra që do të thotë se në Kosovë së paku, sa më i moshuar të bëhesh aq më pak do të besoni se mund të keni ndikim të dukshëm mbi drejtimin e jetës suaj.



Sikurse në anketën e dhjetorit 2007, të anketuarit, meshkuj apo femra, në përgjithësi besojnë se lidhjet familjare (24%) janë faktorët më të rëndësishëm për t'u punësuar në sektorin publik, pastaj ryshfetet dhe trajnimet profesionale. Për femrat, përvoja profesionale renditet si faktori i katërt më i rëndësishëm (13%) për t'u punësuar në sektorin publik. Meshkujt gjithashtu e renditin përvojën profesionale si faktorin e katërt me radhë (12%) (Ilustrimi 2.8).



III. Konkludimet e grupit të ekspertëve mbi çështjet e stabilitetit ekonomik dhe social

Sipas grupit të ekspertëve të mbledhur për të diskutuar rezultatat e kësaj ankete të SPH, çështjet e paraqitura në vijim janë trende brengosëse që kërkojnë vëmendje të veçantë:

- Ndonëse ka patur një rënie të vogël, numri i të anketuarve që deklarojnë gatishmërinë e tyre për t'iu bashkuar protestave publike rreth gjendjes aktuale ekonomike në Kosovë qëndron të jetë mjaftë i lartë.
- Niveli i lartë i të anketuarve që theksojnë se papunësia dhe varfëria paraqesin problemet më të rëndësishme me të cilat përballet Kosova. Me statusin përfundimtar të përcaktuar, zhvillimi ekonomik është bërë sfida madhore për kosovarët.
- Një nivel i vazhdueshëm i ulët i të ardhurave familjare pa përmirësime madhore që nga viti i kaluar.
- Përqindja e lartë e të anketuarve që ndihen të brengosur apo të shqetësuar gjatë ditës për shkak të arsyeve ekonomike në veçanti në mesin e shqiptarëve dhe pakicave të tjera.
- Një rënie e numrit të personave që kanë gjetur vende pune në gjashtë muajt e kaluar.
- Numri relativisht i lartë i personave të pakënaqur me menaxhimin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës.
- Shumë pak konsiderim të arsimit dhe përvojës profesionale si faktorë të rëndësishëm për pu-

nësim në sektorin publik dhe konsiderimi i lartë dhënë lidhjeve familjare dhe ryshfetit si faktorë të rëndësishëm për t'u punësuar në sektorin publik.

Faktorët në vijim janë identifikuar nga diskutimet e grupit të ekspertëve si elemente që i kontribuojnë jostabilitetit ekonomik dhe social:

- Shkalla e ekonomisë joformale që i shtynë disa për të fshehur të ardhurat dhe të raportojnë të hyra më të vogla me qëllim të pagesës më të ulët të tatimeve.
- Perceptimi i gjërë i vazhduar për korrupsion.
- Mungesa e investimeve madhore të investimeve në cilësinë e standardeve të jetës në Kosovë - diçka që i është premtuar qytetarëve për një kohë të gjatë pas pavarësisë.
- Zbatimi përzgjedhës dhe jo i plotë i shumë ligjeve të miratuar nga Kuvendi i Kosovës.
- Problemet e vazhdueshme me energji elektrike dhe shërbimet e tjera publike.
- Kapacitetet joefikase të monitorimit të qeverisë lidhur me ekonominë joformale, në veçanti lidhur me ndërtimin dhe qiradhënien.
- Familjarizmi i madh në institucionet dhe shërbimet publike.
- Konsiderimi i pamjaftueshëm i vlerave të arsimin cilësor për punësim në sektorin publik.

Skenarët e mundshëm alarmues të identifikuar nga Grupi i ekspertëve:

- Ulja e besimit në institucione dhe perceptimi i përhapur i korrupsionit mund të rezultojë në përpjekjen e qytetarëve për të mos përbushur obligimet e tyre lidhur me pagesën e shërbimeve publike dhe të tatimeve.
- Përhapja e vazhduar e "hovit të ndërtimit" të paplanifikuar dhe pa leje krijon një situatë të tensionuar, ku qytetarët të cilët i përbushin obligimet e tyre ndihen të tjetërsuar dhe mundohen t'iu ikin obligimeve.
- Grupi i ekspertëve ka theksuar se marrëdhëniet e tanishme mes institucioneve qeverisëse (qendrore dhe lokale) dhe qytetarëve të Kosovës janë të tensionuara. Nivelet e larta të pakënaqësisë me ndarjen e mjeteve të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës (BKK) dhe menaxhimin e tij të përgjithshëm me siguri janë një pasqyrim i marrëdhënies së tensionuar që

mund të paraqesë një problem për zbatimin e ligjeve, politikave dhe mekanizmave që kërkojnë bashkëpunim të qytetarëve.

- Tani që statusi përfundimtar është përcaktuar, pakënaqësia dhe shqetësimet e të anketuarve rreth punësimit dhe varfërisë janë më të theksuara.
- Nga qeveria e re pritjet që të përbushen premtimet e saja madhore – siç është furnizimi i pandërprerë me energji elektrike, ngritja e pagave në sektorin publik dhe të tjera. Një vonesë në përbushjen e premtimeve zgjedhore mund të shkaktojë arsye për tensione sociale.
- Qeveria e re mund të bëhet e paaftë për t'i përbushur premtimet e saj nëse vazhdon të mospërfillë arsimin cilësor dhe përvojën profesionale për punësim në sektorin publik.

Për të trajtuar problemet ekonomike dhe sociale, Grupi i ekspertëve ka rekomanduar veprimet në vijim:

- Reforma fiskale në veçanti për sa i përket thjeshtësimit dhe uljes së tatimeve të caktuara në nivelin komunal dhe atë qendror.
- Thjeshtësimi i lejeve të ndërtimit, në veçanti nga komunat. Kjo mund të sjellë një lloj rendi dhe kontrolli ndaj ndërtimeve të përhapura ilegale dhe krijim të mjeteve të mëtejshme për komunat për të siguruar një infrastrukturë themelore dhe shërbime publike në lokalitetet e tyre. Komunat dhe autoritetet qendrore duhet të vazhdojnë punën në zbatimin e rregullave dhe rregulloreve lidhur me ndërtimin e paligjshëm.
- Meqë shumë çështje që ndërlidhen me ekonominë janë lidhur me mospërcaktimin e statusit përfundimtar, kjo më nuk është një arsytim i vlefshëm; qeveria duhet të krijojë një listë të prioriteteve lidhur me investimet kapitale dhe menjëherë të fillojë me zbatim. Një financim i mundshëm për këto investime mund të shembull të vijë nga fondi i AKM-së.
- Qeveria duhet të shqyrtojë procedurat e punësimit për institucionet publike dhe duhet t'i kushtojë një vëmendje të veçantë shmangies së familjarizmit.
- Qeveria gjithashtu duhet të prioritetizoj arsimin dhe përvojën profesionale si faktorë kyçë për politikën e punësimit në agjencitë e sektorit publik.


Kapitulli 3

MARRËDHËNIET NDËRETNIKE

I. Trendët kryesorë

Sikurse edhe në anketën e dhjetorit 2007, rezultatet e anketës së majit 2008 tregojnë se pjesa më e madhe e të anketuarve shqiptarë dhe e pakicave të tjera vazhdojnë të besojnë se marrëdhëniet ndëretnike janë duke u përmirësuar (përkatësisht 78% dhe 79%), përderisa vetëm 3% e serbëve besojnë të njëjtën, duke shënuar kështu një rënie prej rreth 17 për qind që nga anketa e dhjetorit 2007 (ilustrimi 3.1). Trendi me rënie drastike i serbëve të cilët besojnë se marrëdhëniet ndëretnike janë duke u përmirësuar ka pësuar ndryshime të mëdha që nga qershori 2007, kur pothuajse më shumë se 90% besonin se marrëdhëniet ndëretnike ishin duke u përmirësuar.

Ilustrimi 3.1: Marrëdhëniet ndëretnike në mes të serbëve dhe shqiptarëve




Siç mund të shihet nga ilustrimi 3.2, që nga periudha raportuese prill-qershor 2007 ka pasur një ngritje të shpejtë në trendin e të anketuarve serbë që besojnë se marrëdhëniet ndëretnike vazhdojnë të mbesin të tensionuara dhe nuk përmirësohen; vetëm në periudhën në mes të tetorit dhe dhjetorit 2007, ka pasur një ngritje prej pesë për qind në këtë aspekt. Përveç kësaj, në mes të dhjetorit 2007 dhe majit 2008, ka pasur edhe një rritje të këtij treguesi prej 11 për qind.

Sa i përket shqiptarëve, pas një rritjeje në këtë tregues në mes të marsit dhe tetorit 2007, anketa e majit 2008 nuk ka regjistruar ndonjë ndryshim të rëndësishëm në krahasim me anketën e dhjetorit 2007.


Rezultatet e anketës së majit 2008 konfirmojnë se arsyt e dhëna për mungesën e përparimit në marrëdhëniet e tensionuara ndëretnike, në veçanti në mes të shqiptarëve dhe serbëve, mbesin të ndryshme varësisht nga përkatësia etnike (ilustrimi 3.3).

Ilustrimi 3.2: Trendi i të anketuarve që konsiderojnë se marrëdhëniet ndëretnike vazhdojnë të jenë të tensionuara dhe nuk janë duke u përmirësuar



Më shumë se gjysma e shqiptarëve besojnë se faktor kryesor për marrëdhëniet e tensionuara në mes të serbëve dhe shqiptarëve është ndikimi i Beogradit (53%), i përcjellë nga mungesa e gatishmërisë së serbëve për t'u integruar në shoqërinë e Kosovës (22%). Pakicat e tjera kanë mendim të ngjashëm, ku 28% citojnë ndikimin e Beogradit dhe 25% mungesën e gatishmërisë së serbëve që të integrohen në shoqërinë e Kosovës, si faktorët kyç për marrëdhëniet e tensionuara në mes të serbëve dhe shqiptarëve. Në anën tjetër, më tepër se 43% (kundrejt 66% në dhjetor 2007) e serbëve besojnë se faktor kryesor për këto marrëdhënie të tensionuara me shqiptarët është qëndrimi i udhëheqjes shqiptare, i përcjellë nga përpjekjet e pamjaftueshme të shqiptarëve për të promovuar integrimin e serbëve në shoqërinë e Kosovës (16%).


Ilustrimi 3.3: Faktorët për marrëdhëniet e tensionuara në mes të serbëve dhe shqiptarëve



II. Kontaktet ndëretnike dhe bashkëjetesa

Anketa e majit 2008 tregon një rënie prej 3% në numrin e të anketuarve serbë të cilët kanë pasur kontakte ndëretnike në më shumë se tre raste (momentalisht qëndron në 41%) duke ndalur kështu rritjen që ishte vërejtur në mes të marsit dhe dhjetorit 2007. Trendi në rritje i atyre të cilët nuk kanë pasur kontakte ndëretnike, i vëzhguar në mes të qershorit 2007 dhe dhjetorit 2007, po ashtu ka ndryshuar drejtimin, duke rënë për rreth 10 për qind në mes të dhjetorit 2007 dhe majit 2008, përderisa numri i atyre me një deri në dy kontakte është ngritur për shtatë për qind që nga anketa e fundit (ilustrimi 3.4).

Ilustrimi 3.4: Shpeshësia e kontakteve ndëretnike brenda tre muajve të fundit




Një tregues tjetër i rëndësishëm i marrëdhënieve ndëretnike, i cili kësaj radhe është pak më inkurajues është gatishmëria e serbëve për të jetuar me shqiptarët në të njëjtin qytet apo rrugë. Sikurse mund të shihet nga ilustrimi 3.5, ka pasur një rritje të dukshme, që nga periudha raportuese dhjetor 2007, në gatishmërinë e serbëve për të jetuar në të njëjtin qytet apo rrugë me shqiptarët. Rreth 38% (kundrejt 36% në dhjetor 2007) e serbëve do të pajtoheshin për të jetuar me shqiptarët në të njëjtin qytet ndërsa rreth 14% (kundrejt 11% në dhjetor 2007) do të pajtoheshin për të jetuar në të njëjtin rrugë me shqiptarët.

Sidoqoftë numri i serbëve të cilët do të pajtoheshin për të punuar së bashku me shqiptarët ka rënë dukshëm – për diku rreth 22 për qind – që nga dhjetori 2007.

Sa u përket martesave ndëretnike, pothuajse të gjithë serbëve u mungon gatishmëria për t'u martuar me shqiptarë.


Ilustrimi 3.5: Serbët që do të pajtoheshin të jetojnë dhe punojnë me shqiptarët



Në anën tjetër, qëndrimet e shqiptarëve në drejtim të jetesës në të njëjtin qytet ose punës së bashku me serbët kanë mbetur të pandryshuara që nga dhjetori 2007. Sidoqoftë, ka pasur një rënie të vogël (prej tre për qind) në gatishmërinë e shqiptarëve për të banuar në rrugën e njëjtë me serbët.

Ngjashëm me serbët, pothuajse të gjithë shqiptarëve iu mungon gatishmëria për t'u martuar me serbët (ilustrimi 3.6).

Ilustrimi 3.6: Shqiptarët që do të pajtoheshin të jetojnë dhe punojnë me serbët



Sidoqoftë, rezultatet e anketës tregojnë se brenda tre muajve të kaluar para datës së anketës, kontaktet ndëretnike ishin relativisht të kënaqshme. Shumica e serbëve (70%) dhe e pakicave të tjera (88%), si dhe më tepër se çereku i shqiptarëve (28%), raportuan

se kanë pasur kontakte me kombësitë e tjera (tabela 3.1). Në anën tjetër, shumica (72% e shqiptarëve, 30% e serbëve dhe rreth 12% e pakicave të tjera) raportuan se nuk kanë pasur kontakte me kombësitë tjera. Në përgjithësi rreth gjysma e kosovarëve kanë pasur kontakte ndëretnike brenda tre muajve të fundit.

Tabela 3.1: Kontaktet me pjesëtarët e përkatësive të tjera etnike gjatë tre muajve të kaluar

	Shqiptarë	Serbë	Të tjerë	Gjithsej
Po kam patur kontakt	27.6%	69.6%	88.2%	45.1%
Jo nuk kam patur kontakt	72.4%	30.4%	11.8%	54.9%
Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%


Sa i përket përpjekjeve të qeverisë së Kosovës për të përmirësuar marrëdhëniet ndëretnike, vetëm rreth një e treta e shqiptarëve dhe asnjë serb së bashku me 26% të pakicave tjera besojnë se aktivitete të tilla nuk kanë pasur ndikim. Shumica e serbëve (69%) së bashku me 4% të pakicave tjera dhe 10% e shqiptarëve mendojnë se këto aktivitete nuk kanë pasur kurrfarë ndikimi.

Tabela 3.2: A kanë pasur ndikim në përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike dhe ngritjen e vetëdijes për procesin e kthimit aktivitetet e ndërmarra nga Qeveria e Kosovës gjatë këtij viti?

	Sipas përkatësisë etnike të grupuar në tre			
	Shqiptarë	Serbë	Të tjerë	Gjithsej
Po	33.0%		26.3%	26.7%
Jo	10.1%	69.0%	4.2%	18.0%
Mund të ketë pasur efekt	29.7%		30.5%	25.3%
Nuk e di	24.7%	22.5%	36.4%	26.5%
Pa përgjigje	2.5%	8.5%	2.5%	3.4%
Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Sa i përket prospekteve për normalizimin e marrëdhënieve ndëretnike, rezultatet e anketës së majit 2008 tregojnë se serbët vazhdojnë të jenë më pesimistët në mesin e të gjitha kombësive në Kosovë. Rreth 38% e serbëve (kundrejt 49% në dhjetor 2007) besojnë se marrëdhëniet ndëretnike në mes të serbëve dhe shqiptarëve kurrë nuk do të normalizohen. Mendimin e njëjtë e ndajnë rreth 15% e shqiptarëve (kundrejt 20% sa kanë qenë në dhjetor 2007) dhe rreth 9% e pakicave të tjera (kundrejt 23% në dhjetor 2007). Më optimistët - ata që besojnë se marrëdhëniet do të normalizohen në të ardhmen e afërt ose të largët - janë shqiptarët (71%), të përcjellë nga pakicat tjera (65%) dhe serbët me vetëm 30% (ilustrimi 3.7).

Ilustrimi 3.7: Prognoza se kur do të normalizohen marrëdhëniet ndëretnike



Sikurse në dhjetor 2007, asnjë serb nuk beson se marrëdhëniet ndëretnike janë tashmë normale, ndërsa në anën tjetër vetëm 3% e shqiptarëve dhe 2% e pakicave të tjera e besojnë këtë për marrëdhëniet ndëretnike.

III. Përfundimet e grupit të ekspertëve në çështjet ndëretnike

Sipas Grupit të ekspertëve që u mblodh për të diskutuar rezultatet e kësaj ankete të opinionit publik të SPH-së, trendët brengosës që kërkojnë vëmendje të veçantë janë si në vijim:

- Numri i lartë i serbëve që besojnë se marrëdhëniet në mes të shqiptarëve dhe serbëve janë të tensionuara dhe do të vazhdojnë të jenë të tilla në të ardhmen.
- Rënia e përqindjes, që nga dhjetori 2007, e të anketuarve serbë të cilët do të pajtoheshin për të punuar me shqiptarët.
- Dallimet e vazhdueshme në mes të serbëve dhe shqiptarëve për atë se kush duhet të punojë më shumë në përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike.
- Shkalla e lartë e pesimizmit në mesin e serbëve për normalizimin e marrëdhënieve ndëretnike.

Faktorët e mëposhtëm janë identifikuar në diskutimet e Grupit të ekspertëve si elementë që i kontribuojnë gjendjes aktuale ndëretnike:

- Do të mund të ndodhte polarizimi dhe radikalizmi i mëtejshëm i shqiptarëve dhe serbëve, në rast se realiteti i passtatusit i Kosovës nuk pranohet nga të gjithë kosovarët

në mënyrë të barabartë. Në rast se manifestimi i dhënës gjatës marsit të fundit në Mitrovicë, përsëritet apo ndodh në ndonjë vend tjetër në Kosovë, atëherë kjo do të mund të përkeqësonte edhe më tej marrëdhëniet ndëretnike.

- Ndikimi i Beogradit në pengimin e integritetit të serbëve të Kosovës në institucionet dhe shoqërinë e Kosovës, në veçanti kërkesat dhe thirrjet nga Beogradi serbëve të Kosovës për të krijuar strukturat e tyre paralele.
- Pjesëmarrja e serbëve të Kosovës në zgjedhjet e Serbisë.

Skenarët e mundshëm alarmues të identifikuar nga grupet e ekspertëve:

- Mosmarrëveshjet në mesin e disa shteteve anëtare të BE-së rreth të ardhmes së EULEX-it dhe dallimet diametralisht të kundërta në mes të BE-së/ShBA-ve dhe Rosisë në lidhje me bashkëjetesën në mes të UNMIK-ut dhe EULEX-it. Sa më pak qartësi që ka në lidhje me praninë ndërkombëtare në Kosovë, aq më shumë hapësirë do të ketë për serbët të lëvizin në drejtim të ndarjes dhe shkëputjes nga pjesa e mbetur e shoqërisë së Kosovës dhe institucionet e qeverisë.

- Vonesa e mëtejshme e njohjes së statusit përfundimtar nga Serbia dhe Rusia ka pasoja negative për marrëdhëniet ndëretnike.
- Mungesa e gatishmërisë së serbëve për të qenë pjesë e institucioneve qeverisëse të Kosovës të zgjedhura në mënyrë demokratike.

Me qëllim që të adresohet situata aktuale ndëretnike, nga Grupi i ekspertëve janë rekomanduar këto veprime:


- Bashkësia ndërkombëtare nuk duhet të lejojë ndonjë mosfunksionim të organeve të pranisë ndërkombëtare në Kosovë. Kjo do të mund të distancoje pjesën më të madhe të kosovarëve, që në anën tjetër do të mund të ndikonte negativisht në marrëdhëniet e tyre me pakicat tjera.
- Gjatë fazës së parë në Kosovë, pas vendosjes së statusit, Qeveria e Kosovës në bashkëpunim me bashkësinë ndërkombëtare duhet të punojë më me zell për t'u siguruar se shteti i ri i nënshtrohet zbatimit të plotë të sundimit të ligjit në baza të barabarta për të gjithë qytetarët e tij.
- Bashkësia ndërkombëtare duhet që menjëherë të fillojë të ndihmojë Qeverinë e Kosovës në lëmin e zhvillimit ekonomik, gjë që padyshim do të rezultonte në përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike në Kosovë.

Kapitulli 4

SIGURIA PUBLIKE DHE PERSONALE

I. Kënaqshmëria me institucionet e sigurisë


Shqiptarët vazhdojnë të jenë shumë të kënaqur me punën e institucioneve të sigurisë në Kosovë. Në anketën e majit 2008, kënaqshmëria me policinë e UNMIK-ut është rritur për pesë për qind, me SHPK-në është rritur për rreth gjashtë për qind, me KFOR-in është rritur për rreth gjashtë për qind dhe me TMK-në është rritur për rreth tre për qind, duke shënuar kështu shkallën më të lartë rekorde prej 98% që nga korriku 2004. TMK-ja vazhdon të jetë institucioni më i besuar i sigurisë, me shkallën më të lartë të kënaqshmërisë në mesin e shqiptarëve (ilustrimi 4.1).



Në mesin e serbëve, kënaqshmëria me Policinë e UNMIK-ut ka shënuar një rritje të konsiderueshme përderisa institucionet e mbetura të sigurisë kanë shënuar rënie në popullaritetin e tyre (ilustrimi 4.2).

Pas një rritje të shpejtë të kënaqshmërisë së serbëve me KFOR-in, në mes të tetorit dhe dhjetorit 2007, rezultatet e anketës së majit 2008 tregojnë një rënie të konsiderueshme në mes të dhjetorit 2007 dhe majit 2008 prej rreth 17 për qind. Kënaqshmëria me TMK-në dhe SHPK-në ka rënë në zero.

Në anën tjetër, kënaqshmëria me Policinë e UNMIK-ut është rritur për rreth shtatë për qind në mes të dhjetorit 2007 dhe majit 2008, ku momentalisht qëndron në 25%.



Ngjashëm me anketat paraprake të tetorit dhe dhjetorit 2007, anketa aktuale gjithashtu tregon se shumica e shqiptarëve dhe pakicat e tjera (përveç serbëve) konsiderojnë se marrëdhëniet në mes të komunitetit dhe policisë janë të mira (tabela 4.1). Sidoqoftë, pak më shumë se 16% e serbëve (kundrejt 29% në dhjetor 2007) konsiderojnë marrëdhëniet në mes të komunitetit dhe policisë as të mira as të këqija, përderisa 36.5% konsiderojnë këto marrëdhënie të jenë të këqija ose shumë të këqija (kundrejt 32% në dhjetor 2007).

Në përgjithësi, ka pasur një rritje prej rreth pesë për qind në numrin e të anketuarve nga të gjitha kombësitë që konsiderojnë se marrëdhëniet në mes të policisë dhe komunitetit janë të mira ose shumë të mira, krahasuar me gjendjen në dhjetor 2007.

Tabela 4.1: Vlerësimi i marrëdhënieve komunitet-policia

	Përkatesia etnike			
	Shqiptarë	Serbë	Të tjerë	Gjithsej
Shumë të mira	14.5%	.5%	14.0%	12.3%
Të mira	53.2%	11.0%	55.5%	47.2%
As të mira e as të këqija	23.1%	16.5%	10.2%	19.8%
Të këqija	3.5%	29.0%	1.3%	7.0%
Shumë të këqija	.7%	7.5%	.4%	1.7%
Nuk e di/pa përgjigje	4.0%	25.0%	18.2%	9.8%
Gjithsej	.9%	10.5%	.4%	2.3%

Kur u pyetën pse ata konsiderojnë se marrëdhëniet komunitet-policia janë të këqija apo shumë të këqija, diku rreth 29% e shqiptarëve thanë se ata ndjejnë se qytetarët nuk dëshirojnë të bashkëpunojmë me policinë, përderisa 24% (kundrejt 28% në dhjetor

2007) thanë se ata ndjejnë se policia është e dobët dhe jokompetente. Grupi i dytë i arsyeve të dhëna nga shqiptarët përfshinë mungesën e besimit nga qytetarët në polici (11% kundrejt 18% në dhjetor 2007) dhe mungesën e përpjekjeve nga ana e policisë për të përmirësuar marrëdhëniet me komunitetet (9%), si dhe ndjenja se policia është e korruptuar dhe e lehtë për t'u përfshirë në ryshfet (9%).

Në anën tjetër, besimi i serbëve në policinë është zvogëluar dukshëm për rreth 14 për qind që dhjetori 2007, momentalisht duke qëndruar në 27% përkundrejt 41% sa ka qenë më parë. Sidoqoftë, për serbët, katër arsyet kryesore pse marrëdhëniet komunitet – polici janë të këqija janë paksa të ndryshme nga ato të dhëna nga shqiptarët dhe përfshijnë: 1) ndjenjën se policia është e dobët dhe jokompetente (34% kundrejt 21% në dhjetor 2007), 2) mungesën e besimit në polici (27%), 3) ndjenjën se policia është e korruptuar dhe e lehtë për ryshfet (26%), 4) mungesën e bashkëpunimit të qytetarëve me polici (5%), dhe 5) nuk ka tentime nga ana e policisë për të përmirësuar marrëdhëniet me komunitetin (3%).

Për pakicat e tjera, katër arsyet kryesore përfshijnë: 1) mungesën e dëshirës për të bashkëpunuar me policinë (37%), 2) mungesën e besimit në polici (26%), 3) ndjenjën se policia është e dobët dhe jokompetente (11%) dhe 4) policia nuk tenton të përmirësojë marrëdhëniet me komunitetin (7%).

Tabela 4.2: Arsyet për marrëdhënie të këqija komunitet – polici

	Përkatësia etnike			
	Shqiptarë	Serbë	Të tjerë	Gjithsej
Njerëzit nuk i besojnë policisë	11.3%	26.7%	25.9%	16.7%
Njerëzit nuk duan të bashkëpunojnë me policinë	28.9%	4.8%	37.0%	22.6%
Njerëzit ndjejnë se policia është e dobët dhe jokompetente	24.3%	34.3%	11.1%	26.1%
Policia nuk mundohet të përmirësojë marrëdhëniet me komunitetin	8.8%	2.9%	7.4%	7.0%
Njerëzit ndjejnë se policia është e korruptuar dhe e lehtë për ryshfet	8.8%	25.7%		12.9%
Diçka tjetër	5.9%			3.8%
Nuk di	10.0%	3.8%	18.5%	8.9%
Gjithsej	2.1%	1.9%		1.9%

Në përgjithësi arsyeja kryesore e dhënë për marrëdhënie të këqija komunitet – polici është ndjenja se policia është e dobët dhe jokompetente (26%), e përcjellë nga mungesa e gatishmërisë në mesin e qytetarëve për të bashkëpunuar me policinë (23%). Në dhjetor 2007,

dy arsyet kryesore për marrëdhëniet e këqija komunitet – polici ishin ndjenja se policia është e dobët dhe jokompetente dhe mungesa e besimit në polici.

II. Siguria personale dhe familjare

Të anketuarit u pyetën për të radhitur se çfarë shohin si kërcënimin më të madh për sigurinë e familjeve të tyre (tabela 4.3). Kur u bënë analizat sipas përkatësisë etnike të të anketuarve, katër kërcënimet kryesore për të shqiptarë, sipas anketës së majit 2008, përfshinin: 1) narkotikët (19%), 2) vjedhjet (18%), 3) zjarret (11%), dhe 4) plaçkitjet (10%).

Serbët identifikojnë kërcënimet e njëjta sikurse edhe shqiptarët, duke përfshirë 1) vjedhjet (28%), 2) vrasjet (21%), 3) krimin e organizuar (20%), dhe 4) varfërinë (10%). Sa u përket të anketuarve nga pakicat tjera, kërcënimet kryesore përfshijnë: 1) zjarret (22%), 2) narkotikët (18%), 3) vjedhjet (15%), dhe plaçkitjet (14%).

Në përgjithësi, kërcënimet kryesore ndaj sigurisë së familjes të identifikuar nga kosovarët, përfshijnë: 1) vjedhjet (19%), 2) narkotikët (16%), 3) plaçkitjet (10%), dhe 4) krimin e organizuar (9.5%).

Tabela 4.3: Kërcënimet ndaj sigurisë së familjes për nga përkatësia etnike

	Shqiptarë	Serbë	Të tjerë	Gjithsej
Plaçkitjet	10.1%	2.5%	14.4%	9.7%
Vjedhjet	18.2%	28.0%	14.8%	19.1%
Kidnapimet	5.6%	8.0%	1.7%	5.3%
Vrasjet	5.6%	21.0%	4.2%	7.7%
Aksidentet në trafik	8.7%	1.0%	3.0%	6.5%
Krimi i organizuar	6.1%	20.0%	13.6%	9.5%
Aksidentet në shtëpi	1.7%	.5%		1.2%
Zjarret	11.1%	7.0%	22.0%	12.4%
Varfëria	7.6%	10.0%	4.2%	7.3%
Sëmundjet infektuese	1.1%		.4%	.8%
Narkotikët	18.9%	.5%	17.8%	15.9%
Reketimi	1.3%		.4%	.9%
Tjetër	2.6%		3.0%	2.3%
Nuk e di	.5%			.3%
Pa përgjigje	1.0%	1.5%	.4%	1.0%
Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Rezultatet e anketës së majit 2008 tregojnë një zvogëlim të konsiderueshëm në nivelin e perceptimit në mesin e serbëve sa i përket sigurisë përderisa janë jashtë në rrugë. Diku vetëm rreth 6.5% e serbëve ndjehen të sigurt tani (shumë të sigurt dhe disi të sigurt), që përfaqëson një zvogëlim të dukshëm prej rreth 26 për qind që nga dhjetori 2007. Kjo mund të jetë e ndërlik-


hur me zvogëlimin e kënaqshmërinë me institucionet e sigurisë në mesin e serbëve, veçanërisht sa i përket KFOR-it dhe institucioneve lokale të sigurisë.

Sa i përket shqiptarëve, rreth 79% (kundrejt 45% në dhjetor 2007) ndjehen shumë të sigurt dhe disi të sigurt, së bashku me pakicat tjera, prej të cilave rreth 75% (kundrejt 51%) ndjehen shumë të sigurt dhe disi të sigurt (tabela 4.4).


Tabela 4.4: Siguria krahasuar me krimin dhe dhunën jashtë shtetësisë

	Përkatësia etnike			
	Shqiptarë	Serbë	Të tjerë	Gjithsej
Shumë të sigurt	22.2%	1.0%	15.7%	17.8%
Paksa të sigurt	56.6%	5.5%	58.9%	49.2%
Paksa të pasigurt	11.0%	52.5%	17.4%	18.5%
Shumë të pasigurt	9.2%	39.0%	6.4%	13.2%
Pa përgjigje	1.0%	2.0%	1.7%	1.3%
Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Siç mund të shihet nga ilustrimi 4.3 në mesin e shqiptarëve ndjenja e sigurisë rritet pothuajse në mënyrë lineare me moshën, përveç atyre që janë në grupmoshën më të vjetër sesa 46 vjeçar. Sa më i ri që je më pak i sigurt ndjehesh. Në mesin e shqiptarëve, grupmosha prej 18-24 vite është grupi me përqindjen më të ultë (77% kundrejt 32% në dhjetor 2007) të ndjenjës së sigurisë në rrugë, përderisa grupi që ndihet më i sigurti është grupmosha 37 – 45 vite (81% kundrejt 57% në dhjetor 2007). Kështu që në mes të dhjetorit 2007 dhe majit 2008, ndjenja e sigurisë jashtë shtetësisë është rritur dukshëm për shqiptarët në mes të.



Sidoqoftë, për serbët nuk mund të nxjerrët ndonjë lidhje reciproke në mes të grupmoshave dhe ndjenjës së sigurisë. Sikurse edhe u paraqit në ilustrimin 4.4, ka ndryshime të vazhdueshme të konsiderueshme në mes të grupmoshave sa i përket ndjenjës së sigurisë përderisa gjenden jashtë në rrugë. Grupmosha e serbëve me përqindjen më të ultë të atyre që ndjehen të sigurt (vetëm 4%) është në mes të moshës 37-45.





Përderisa, grupmosha e njerëzve në moshën në mes 18-24 ka përqindjen më të lartë (11%) të atyre që ndjehen të sigurt.

Ndjenja e sigurisë për regjionin e Mitrovicës dhe regjionet tjera të Kosovës është paraqitur në ilustrimin 4.5. Për shkak të situatës shumë komplekse, ende duke qenë një qytet i ndarë në vija etnike, ka arsye të supozohet se situata e sigurisë në Mitrovicë perceptohet ndryshe nga serbët dhe shqiptarët dhe se serbët e Kosovës në Mitrovicë mund të ndjehen më të sigurt sesa diku tjetër në Kosovë.

Në krahasim me rezultatet e anketës së dhjetorit 2007 të cilat treguan se më tepër se 60% e serbëve raportuan se ndjehen të sigurt në Mitrovicë dhe vetëm 2% raportuan të ndjehen mirë në regjionet tjera të Kosovës, rezultatet e anketës në maj 2008 tregojnë një zvogëlim të shpejtë prej 43 për qind tek serbët të cilët raportojnë se ndjehen të sigurt në Mitrovicë. Sa i përket pjesës së mbetur të Kosovës, asnjë i anketuar serb nuk ka raportuar se ndjehet i sigurt.

Edhe njëherë, anketa e tanishme mu sikurse edhe ajo e mëparshme, përkundër besimit të zakonit që



ndoshta është paksa befasues, tregon se shqiptarët raportojnë ndjenjë paksa më të sigurt në regjionin e Mitrovicës sesa në regjionet tjera. Rreth 89% e shqiptarëve ndjehen të sigurt në Mitrovicë, përderisa rreth 78% ndjehen të sigurt në regjionet tjera, ndërsa vetëm 76% në regjionin e Prishtinës (ilustrimi 4.7).

shembull për vetëmbrojtje. Megjithatë, vetëm 1% deklaruan se bartja e armëve duhet të lejohet madje edhe në vende publike (tabela 4.5).

III. Armët e zjarrit dhe shpërbërja e Trupave të Mbrojtjes së Kosovës

Posedimi i armëve të zjarrit nga individët në Kosovë mbetet si një problem i cili ende duhet të zgjidhet. Në pyetjen nëse individët duhet të lejoheshin për të bartur armë zjarri (armë) në vende publike, pjesa më e madhe e të anketuarve (81% kundrejt 73% në dhjetor 2007) deklaruan se posedimi i armëve të zjarrit në vende publike nuk do të duhej të lejohet fare. Sidoqoftë, rreth 12% (kundrejt 16% në dhjetor 2007) mendojnë se posedimi i armëve të zjarrit duhet të lejohet në vende publike nën kushte të caktuara, sikurse për

Nëpër regjione, është interesante të përmendet se Mitrovica (kundrejt Gjilanit në dhjetor 2007) ka regjistruar përqindjen më të lartë të të anketuarve (17%) të cilët kanë deklaruar se bartja e armëve në vende publike nën rrethana të caktuara (siç është vetëmbrojtja) është në rregull. Ferizaj (kundrejt Gjakovës në dhjetor 2007) ka përqindjen më të ulët (5%) të të anketuarve të cilët mendojnë njëjtë.

Pothuajse gati gjysma e të anketuarve (rreth 46%) mendojnë se regjistrimi apo licencimi i armëve të zjarrit do të shtonte sigurinë. Rreth 32% mendojnë se regjistrimi dhe licencimi i armëve të zjarrit vetëm sa do ta rriste pak sigurinë, në krahasim me rreth 11% të cilët ndjejnë se siguria nuk do të përmirësohej fare përmes këtij procesi (tabela 4.6).

Tabela 4.5: A mendoni se bartja e armëve në vende publike duhet të lejohet?

	Prishtinë	Mitrovicë	Prizren	Pejë	Ferizaj	Gjakovë	Gjilan	Gjithsej
Po	.9%	.5%	.4%	.6%			2.8%	.8%
Vetëm në rrethana të caktuara (për vetëmbrojtje)	11.7%	17.4%	6.6%	16.9%	5.4%	15.7%	15.9%	12.1%
Jo	81.7%	67.9%	92.3%	74.7%	86.9%	82.9%	74.5%	80.8%
Nuk e di	3.2%	9.5%	.4%	6.5%	5.4%	1.4%	2.1%	3.9%
Pa përgjigje	2.6%	4.7%	.4%	1.3%	2.3%		4.8%	2.4%
Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Në mesin e të gjitha regjioneve të Kosovës, Peja (kundrejt Mitrovicës në dhjetor 2007) tregon përqindjen më të ulët (31%) të atyre që mendojnë se regjistrimi dhe licencimi i armëve të zjarrit do të përmirësonte shumë sigurinë. Përderisa Prishtina tregon përqindjen më të lartë (20%) të atyre të cilët mendojnë se licencimi dhe regjistrimi i armëve nuk do ta përmirësonte fare sigurinë.

Pritja e shpërbërjes së Trupave të Mbrojtjes së Kosovës (tashmë e miratuar nga institucionet qeverisëse të Kosovës) dhe krijimi i Forcës së re të Sigurisë së Kosovës (FSK) sipas Planit të Ahtisarit janë drejtpërdrejtë të ndërlidhura me situatën e sigurisë në Kosovë.

Kur janë pyetur se çfarë duhet të ndodh me pjesëtarët e tanishëm të TMK-së, të cilët nuk do të jenë në gjendje t'i bashkohen FSK-së, në përgjithësi 32% e kosovarëve deklaruan se këta individë duhet të trajtohen ndryshe nga shërbyesit e tjerë civilë të larguar nga puna sepse ata përfaqësojnë heroizmin e UÇK-së në çlirimin e Kosovës (tabela 4.7). Pothuajse gjysma e shqiptarëve (46%) ndajnë këtë mendim. Përkundrazi asaj se çfarë thonë shqiptarët, rreth 9.5% e serbëve mendojnë se pjesëtarët e TMK-së të cilët nuk do të jenë në gjendje t'i bashkohen FSK-së duhet të trajtohen ndryshe nga shërbyesit tjerë civil të larguar nga puna sepse ata përfaqësojnë veprat kriminale të kryera nga UÇK-ja, në krahasim me shumicën e serbëve të cilët thjeshtë nuk i janë përgjigjur kësaj pyetje apo edhe nuk kanë ditur (63%). Rreth 37% e pakicave të tjera mendojnë se pjesëtarët e TMK-së të cilët nuk do të jenë në gjendje t'i bashkohen FSK-së duhet të trajtohen ndryshe nga shërbyesit tjerë civilë të larguar

nga puna sepse ata përfaqësojnë heroizmin e UÇK-së në çlirimin e Kosovës, përderisa 23% mendojnë se këta individë duhet të trajtohen sikurse cilido shërbyes civil i larguar nga puna.

Tabela 4.7: Çfarë duhet të ndodh me ish- pjesëtarët e TMK-së të cilët nuk do të përfshihen në FSK?

	Ethnicity grouped three			
	K-Albanian	K-Serb	Other	Total
Të trajtohen njëjtë sikur çdo shërbyes tjetër civil që i skadon marrëdhënia e punës	6.6%		23.3%	8.6%
Të trajtohen ndryshe nga çdo shërbyes tjetër civil që i skadon marrëdhënia e punës, sepse pjesëtarët e TMK-së i kanë shërbyer Kosovës	37.3%		27.1%	29.8%
Të trajtohen ndryshe nga çdo shërbyes tjetër civil që i skadon marrëdhënia e punës, sepse pjesëtarët e TMK-së përfaqësojnë heroizmin e UÇK-së	45.8%		10.2%	32.4%
Të trajtohen ndryshe nga çdo shërbyes tjetër civil që i skadon marrëdhënia e punës, sepse pjesëtarët e TMK-së përfaqësojnë aktet kriminale të UÇK-së	.6%	9.5%	.4%	1.9%
Tjetër.	8.7%	27.5%	34.3%	16.2%
ND/PP	1.0%	63.0%	4.7%	11.1%
Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Tabela 4.6: Sa mendoni se rrit sigurinë regjistrimi dhe licencimi i armëve të zjarrit?

	Prishtinë	Mitrovicë	Prizren	Pejë	Ferizaj	Gjakovë	Gjilan	Gjithsej
Shumë	41.3%	38.4%	56.3%	31.2%	58.5%	58.6%	46.9%	46.0%
Pak	30.7%	27.4%	32.7%	48.1%	23.8%	30.0%	31.7%	32.1%
Aspak	20.3%	9.5%	9.2%	3.2%	6.2%	5.7%	9.7%	11.1%
Nuk e di	4.9%	18.9%	1.8%	16.2%	9.2%	5.7%	6.9%	8.3%
Pa përgjigje	2.9%	5.8%		1.3%	2.3%		4.8%	2.5%
Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

IV. Përfundimet e Grupit të ekspertëve për çështjet e sigurisë publike dhe personale

Sipas grupit të ekspertëve që u mbledhën dhe diskutuan rezultatet e kësaj ankete të opinionit publik të SPH-së, trendët e poshtëshënuar janë brengosëse dhe kërkojnë vëmendje të veçantë:

- Një rënie, që nga dhjetori 2007, e përqindjes tashmë të ulët të serbëve të cilët janë të kënaqur me punën e Shërbimit Policor të Kosovës, KFOR-it dhe TMK-së.
- Numri i madh i të anketuarve serbë të cilët raportuan se ndjehen të pasigurt kur janë jashtë në rrugë në Mitrovicë dhe se pothuajse asnjë serb nuk ndjehet i sigurt në regjionet tjera të Kosovës.
- Një numër relativisht i rëndësishëm i të anketuarve të cilët mendojnë se regjistrimi dhe licencimi i armëve të zjarrit nuk do të përmirësojë tepër shumë sigurinë.
- Një ndarje e plotë në mendime në mesin e serbëve dhe shqiptarëve në lidhje me fatin e ish-pjesëtarëve të TMK-së të cilët nuk do të jenë në gjendje t'i bashkohen FSK-së.

Çështjet e poshtëshënuara janë identifikuar si probleme potenciale që i kontribuojnë çështjeve të sigurisë publike dhe personale:

- Mungesa e raportimit të rregullt në media nga SHPK-ja dhe KFOR-i (p.sh. raportet mujore për çështjet dhe statistikën e sigurisë).
- Situata e rëndë ekonomike në ekonomi familjare dhe mungesa e përmirësimit në këtë kupim që është parakusht për krime dhe dhunë.
- Mungesa e besimit të serbëve në SHPK.
- Ngjarjet e dhunshme gjatë marsit 2008 në Mitrovicë
- Numri i madh i të anketuarve në Mitrovicë të cilët përkrahin bartjen e armëve në vende publike nën rrethana të caktuara.

Skenarët e mundshëm të identifikuar nga Grupi i ekspertëve:

- Marrëdhëniet ndëretnike mund të degradohen edhe më tej për shkak të mungesës së besimit të serbëve në institucionet e sigurisë, veçanërisht në SHPK-në.
- Siguria për të gjithë mund të degradohet edhe më tej për shkak të mungesës së prosperitetit ekonomik, i cili mund të shkaktojë sjellje edhe më agresive tek grupe të caktuara të njerëzve.
- Dështimi për të trajtuar ashtu siç duhet ish-pjesëtarët e TMK-së, të cilët nuk janë në gjendje t'i bashkohen FSK-së do të mund të shkaktojë tensione sociale, veçanërisht kur merren parasysh lidhjet emocionale të cilat shumë kosovarë i kanë me këtë çështje.

Grupi i ekspertëve rekomandon këto veprime si të domosdoshme për të adresuar çështjet e sigurisë publike dhe personale:

- Institucionet e Kosovës për siguri duhet të punojnë më për së afërmi me komunitetet pakicë përmes programeve kreative të cilat do të ndihmonin në ngritjen e besimit të pakicave në këto institucione.
- Raporte më të mira dhe më të shpeshta zyrtare për parandalimin e krimeve duhet t'i vihen në dispozicion publikut, gjë që do të ndihmonte në ngritjen e besimit në siguri.
- Veçanërisht në regjionin e Mitrovicës duhet të ndërmerret regjistrimi dhe licencimi i armëve të zjarrit.
- Duhet të planifikohen dhe të jenë të gatshme planet e pensionimit për ish-pjesëtarët e TMK-së, të cilët nuk do të jenë në gjendje t'i bashkohen FSK-së, kur kjo e fundit të themelohet (preferohet që kjo të jetë në mënyrën e cila do të kënaq ata të cilët preken nga kjo sikurse edhe u përmend në tabelën 4.7).
- Qeveria e Kosovës në bashkëpunim me pranimë ndërkombëtare në Kosovë duhet të intervenojë për t'u siguruar se në Kosovë nuk veprojnë struktura paralele të qeverisjes apo sigurisë.

Kapitulli 5

NGJARJET E MARSIT: NDIKIMI I TYRE NË ÇËSHTJET E SIGURISË DHE MARRËDHËNIET NDËRETNIKE

Një muaj pasi që Kuvendi i Kosovës ka shpallur pavarësinë e Kosovës dhe njohjes cilësore të saj nga fuqitë kryesore evropiane dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhuna dhe trazirat qytetare shpërthyen në regjionin verior të Kosovës, kryesisht në qytetin e Mitrovicës cili është i ndarë në vija etnike.

Përqendrim i këtij kapitulli nuk është për të përcaktuar shkaqet apo për t'ia lënë fajin ndokujt për protestat e dhunshme dhe trazirat që u shkaktuan. Ky kapitull më tepër do të analizojë ndikimin që këto ngjarje kanë pasur në marrëdhëniet ndëretnike dhe sigurinë në Kosovë.


Këtu do të prezantohen disa indikatorë të marrëdhënieve ndëretnike dhe sigurisë duke u bazuar në të dhënat nga anketa e kryer nga Riinvesti në fund të majit/fillim të prillit 2008. (Për qëllime të përdorimit të shprehjes, kësaj ankete do t'i referohemi si anketa e marsit 2008 apo "anketa e shpejtë").

Problemi kryesor dhe potenciali për protesta

Sipas kësaj ankete të shpejtë, shqiptarët kanë zgjedhur papunësinë si problem kryesor me të cilin ballafaqohet Kosova (31%), i përcjellë nga mungesa e energjisë elektrike (25%). Sa i përket serbëve, problem kryesor me të cilin ballafaqohet Kosova është siguria publike dhe personale (66%), i përcjellë nga rezultati i padëshirueshëm i statusit përfundimtar (15%). Të anketuarit nga pakicat e tjera kanë cekur varfërinë (28.9%) e përcjellë nga papunësia prej 25.6%.

Tabela 5.1: Problemi kryesor me të cilin ballafaqohet Kosova

	Përkatësia etnike			
	Shqiptarë	Serbë	Të tjerë	Gjithsej
Infrastruktura rrugore	3.8%	.4%	2.8%	3.0%
Furnizimi me energji elektrike	24.6%		8.9%	17.0%
Problemet me hapësirat urbane (ndërtimi i egër)	.5%		.4%	.4%
Ndotja e mjedisit	1.3%		.4%	.9%
Varfëria	23.3%		28.9%	20.1%
Çmimet	1.9%		2.8%	1.7%
Shërbimet shëndetësore	.8%		.4%	.6%
Siguria publike dhe personale	.3%	65.9%	1.2%	12.4%
Arsimi	.1%	1.7%	.4%	.5%
Marrëdhëniet ndëretnike	1.7%		.8%	1.2%
Papunësia	31.3%	11.4%	25.6%	26.6%
Paqartësia rreth statusit përfundimtar të Kosovës	.3%		19.1%	3.9%
Rezultati i padëshirueshëm i statusit final të Kosovës	.1%	15.3%	.4%	2.9%
Problemet sociale (pensionet, invalidët, jetimët etj.)	.5%		4.5%	1.2%
Fati i të zhdukurve	2.2%	.4%	.4%	1.5%
Krimi i organizuar	.8%	3.9%	.4%	1.3%
Vrasjet e pazgjidhura	.6%		.8%	.6%
Korrupsioni	5.0%	.4%	.8%	3.3%
Sjellja asociale (prostitucioni, narkotikët, alkoolizmi, trafikimi)	.1%		.4%	.2%
Të tjera. Çka?	1.0%	.4%	.4%	.8%
Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%



Për më tepër, kjo anketë tregon një rritje të rëndësishme në gatishmërinë e serbëve për të protestuar për arsye politike, me 89.5% e serbëve të cilët raportuan një gatishmëri të tillë. Kjo ka qenë përqindja më e lartë e regjistruar e serbëve që nga shtatori 2006, të cilët kanë qenë të gatshëm për të protestuar për arsye politike. Përkundrazi, gatishmëria për të protestuar për arsye politike në mesin e shqiptarëve ka qenë më e ulët për rreth 15 për qind, në krahasim me atë të dhjetorit 2007 (tabela 5.2).

Siguria

Rezultatet nga kjo anketë e shpejtë nuk tregojnë ndonjë ndryshim të madh në nivelin e kënaqshmërisë së shqiptarëve me institucionet e sigurisë në Kosovë. Në krahasim me dhjetorin 2007, anketa e shpejtë e bërë në fund të marsit 2008 tregon një rritje të qëndrueshme të kënaqshmërisë së shqiptarëve me të gjitha institucionet e sigurisë, përveç për TMK-në. Më tepër se 90% e shqiptarëve kanë qenë të kënaqur me punën e TMK-së, KFOR-it dhe SHPK-së, përderisa rreth 9% kanë qenë të kënaqur me punën e policisë së UNMIK-ut (ilustrimi 5.1).


Tabela 5.2: Gatishmëria për të protestuar për arsye politike

	Përkatësia etnike			
	Shqiptarë	Serbë	Të tjerë	Gjithsej
Po	43.3%	89.5%	40.7%	51.1%
Jo	50.8%	2.2%	45.1%	40.8%
Nuk përgjigjet	6.0%	8.3%	14.2%	8.0%
Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Sa i përket gatishmërisë së kosovarëve për të protestuar për arsye ekonomike, anketa e marsit 2008 tregon se në përgjithësi më tepër se 63% e kosovarëve do të protestonin për shkak të situatës ekonomike. Kjo përqindje është dukshëm më e ulët për serbët në krahasim me atë të dhjetorit 2007, (67% kundrejt 88% në dhjetor 2007). Ka pasur një rënie në vullnetin e shqiptarëve (për rreth nëntë për qind) dhe të tjerëve (për rreth 14 për qind) për të protestuar për arsye ekonomike kundrejt periudhës raportuese dhjetor 2007.

Tabela 5.3: Gatishmëria për të protestuar për arsye ekonomike

	Shqiptarë	Serbë	Të tjerë	Gjithsej
	Po	65.6%	66.8%	54.1%
Jo	28.8%	14.4%	34.6%	27.3%
Nuk përgjigjet	5.6%	18.8%	11.4%	9.1%
Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%




Në anën tjetër, anketa e bërë në fund të marsit 2008 tregon një rënie të madhe të nivelit të kënaqshmërisë në mesin e serbëve në drejtim të të gjitha institucioneve të sigurisë në Kosovë. Përderisa Policia e UNMIK-ut ende një nivel kënaqshmërie prej 2%, institucionet tjera të sigurisë kanë një nivel të kënaqshmërisë prej vetëm 1% në mesin e serbëve (ilustrimi 5.2).

Marrëdhëniet ndëretnike

Në pyetjen se kur do të normalizohen marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë, më tepër se 45% e serbëve deklaruan se marrëdhëniet nuk do të normalizohen kurrë, përderisa më tepër se 21% deklaruan se marrëdhëniet do të normalizohen në të ardhmen e largët. Anketa dhe zbuluar se shqiptarët dhe pakicat tjera vazhdojnë të jenë më optimist për normalizimin e marrëdhënieve ndëretnike – ku diku rreth 48% e shqiptarëve dhe 28% e të tjerëve kanë deklaruar se këto marrëdhënie do të normalizohen në të ardhmen e largët, përderisa vetëm 14% e shqiptarëve dhe rreth 17% e të tjerëve deklaruan se këto marrëdhënie nuk do të normalizohen kurrë (ilustrimi 5.3).


Ilustrimi 5.3: Prognosa se kur do të normalizohen marrëdhëniet ndëretnike



Sa i përket gatishmërisë së shqiptarëve dhe serbëve për të punuar ose jetuar në qytetin apo rrugën e njëjtë me njëri-tjetrin, rezultatet e anketës së kryer në fund të marsit 2008, tregojnë se shqiptarët vazhdojnë të jenë më të gatshëm për ta bërë këtë.


Vetëm 9% e serbëve është e gatshme për të punuar me shqiptarët, që përfaqëson një rënie drastike prej diku rreth 37 për qind që nga dhjetori 2007. Përderisa diku rreth 17% e serbëve do të pajtohej për të jetuar në të njëjtin qytet me shqiptarët dhe diku rreth 7% do të pajtohej për të jetuar në të njëjtën rrugë me shqiptarët, ndërsa vetëm 1% do të pajtohej për t'u martuar me personat e kombësisë shqiptare. Në përgjithësi, gatishmëria e serbëve për të jetuar apo punuar me shqiptarët ka rënë dukshëm në mes të mes të dhjetorit 2007 dhe marsit 2008 (ilustrimi 5.3).

Ilustrimi 5.4: Serbët të cilët do të pajtoheshin për të jetuar apo punuar me shqiptarët



Në anën tjetër, po ashtu ka pasur një rënie të vogël të gatishmërisë së shqiptarëve për të jetuar apo punuar me serbët, në krahasim me dhjetorin 2007. Diku rreth 46% do të pajtoheshin për të punuar me serbët (kundrejt 49% në dhjetor 2007), 42% do të pajtohej për të jetuar në qytetin e njëjtë me serbët (kundrejt 49% në dhjetor 2007), dhe 38% do të pajtoheshin për të jetuar në rrugë të njëjtë me serbët (kundrejt 43% në dhjetor 2007). Sikurse edhe serbët, pothuajse asnjë shqiptar nuk do të pajtohej për t'u martuar me persona të kombësisë serbe (ilustrimi 5.4).

Ilustrimi 5.5: Shqiptarët të cilët do të pajtoheshin për të jetuar apo punuar me shqiptarët



Kapitulli 6

ANALIZA TË KORRUPSIONIT

Nga: Mytaher Haskuka

Kjo pjesë e raportit paraqet analiza të shkurtra për perceptimet e korrupsionit sipas disa faktorëve demografik dhe marrëdhënia e tyre me treguesit ekonomik dhe psikosocial. Së dyti paraqet trendët në lidhje me raportimin sipas shërbimeve të ndryshme publike dhe faktorëve demografik për kushtëzimin e shërbimeve publike me rryshfet, dhurata dhe favore tjera.

Perceptimet e korrupsionit

Në përgjithësi, përqindja e atyre që mendojnë se ka korrupsion në shkallë të madhe në institucione/organizata të ndryshme është bukur e lartë. Për 7 nga gjithsej 14 subjekte, 30% e kosovarëve mendojnë se korrupsioni është i pranishëm në "shkallë të madhe" (shiko ilustrimin 6.1)


Sikurse është vërejtur në anketat e mëparshme, KEK-u dhe AKM-ja vazhdojnë listën e institucioneve të Kosovës, të cilat perceptohet se kanë korrupsion "në

shkallë të lartë", rreth 69% e të anketuarve mendojnë se ka korrupsion të shkallës së lartë në KEK dhe 53% e të anketuarve kanë mendim të njëjtë për AKM-në.


Duke analizuar trendët e kohëve të fundit KEK-u dhe AKM-ja, për herë të parë, janë përcjellë nga sektori shëndetësor (spitalet). Në anketën e majit 2008, rreth 47% e të anketuarve besonin se ka korrupsion në sektorin shëndetësor, kundrejt 38% të cilët mendonin këtë në dhjetor 2007.

Në anën tjetër, numri i atyre që perceptojnë korrupsionin në shkallë të madhe në administratën qendrore ka rënë një 32% nga 45% sa ka qenë në anketën e dhjetorit 2007. Trendë të ngjashëm mund të shihen në lidhje me komunat – në tetor 2007 më shumë se 36 e të anketuarve kanë menduar se ka korrupsion brenda këtij institucioni, përdërisa në maj 2008 ky perceptim ka rënë në 21 % (shih ilustrimin 6.2).

Ilustrimi 6.1: Perceptimet e pranisë së korrupsionit "në shkallë të madhe" në institucionet e Kosovës



Ilustrimi 6.2: Përqindja e të anketuarve të cilët mendojnë se ka korrupsion në shkallë të madhe në institucione të ndryshme, për periudhën tetor 2007- maj 2008.



Shkalla e perceptimit të korrupsionit


Për analiza më të thella të faktorëve të ndryshëm (ndryshoret demografike dhe psikosociale) të cilët mund të kontribuojnë në rritjen e perceptimeve për korrupsion, është përlogaritur një ndryshore e vazhdueshme për secilin të anketuar duke i shtuar asaj përgjigjet po-huese (d.m.th. korrupsioni i pranishëm në "shkallë të mesme" ose "shkallë të lartë") ndaj pyetjes për praninë e korrupsionit në institucione. Ndryshorja e cila doli si rezultat i kësaj është quajtur "shkalla e perceptimit të

korruptionit". Kjo është përdorur si ndryshore e varur dhe për analiza statistikore (korrelacion, regresion dhe ANOVA (analizat e mospërputhjes)) për të identifikuar faktorët e rëndësishëm dhe marrëdhëniet me ndryshoret demografike dhe psikosociale.

Përkritazi me faktorët demografikë sikurse janë gjinia, vendbanimi, regjioni dhe papunësia, nuk është regjistruar ndonjë lidhje e rëndësishme. Lidhja e vetme e rëndësishme është gjetur sa i përket moshës; ku me rritjen e moshës rritet edhe shkalla e perceptimit të korruptionit.


Në anën tjetër analizat e marrëdhënive në mes të shkallës së perceptimit të korruptionit dhe faktorëve të ndryshëm psiko-social (d.m.th. ndjenja e shqetësimit, pesimizmi ekonomik, pesimizmi politik, gatishmëria për të protestuar për arsye politike dhe gatishmëria për të protestuar për arsye ekonomike) kanë zbuluar rezultate të rëndësishme². Ata që u përgjigjen se ndjehen pothuajse gjithmonë të shqetësuar apo brengosur kanë pasur perceptime dukshëm më të larta për korruptionin sesa ata që vetëm nganjëherë ose kurrë nuk ndjehen të brengosur apo shqetësuar gjatë ditës.

Ilustrimi 6.3: Rezultati mesatar i perceptimit të korruptionit sipas ndjenjës së shqetësimit.



Ngjashëm, analizat e marrëdhënive në mes të kënaqshmërisë³ me drejtimet politike dhe ekonomike në Kosovë dhe perceptimet e korruptionit kanë zbuluar se ata të cilët janë më pesimist për drejtimin politik dhe ekonomik të Kosovës kanë perceptim më të lartë për korruptionin. Në mënyrë specifike, ata të cilët janë më pak të kënaqur, perceptojnë se korruptioni është shumë më shumë i pranishëm brenda institucioneve në krahasim me ata të cilët janë më tepër të kënaqur (ilustrimi 6.4)

Ilustrimi 6.4: Perceptimet e shkallës së korruptionit sipas përgjigjeve në pyetjet në lidhje me kënaqshmërinë me drejtimin ekonomik dhe politik të Kosovës.



Ngjashëm, rezultate të rëndësishme janë vërejtur kur të anketuarit janë grupuar sipas përgjigjeve të tyre për protestë politike apo ekonomike. Të anketuarit të cilët kanë qenë më tepër të gatshëm për të protestuar për arsye ekonomike kanë pasur perceptim më të lartë të shkallës së korruptionit sesa ata të cilët nuk kanë dashur të protestojnë. Ngjashëm, të anketuarit të cilët ishin më të gatshëm për të protestuar për arsye politike kanë pasur perceptim më të lartë të shkallës së korruptionit sesa ata të cilët nuk dëshiruan t'i bashkoheshin protestave⁴.

² Analizat janë bërë me ANOVA duke marrë parasysh strukturën e grupeve dhe perceptimet e tyre për korruptionin si ndryshore të varura dhe pyetjet për pesimizmin dhe protestën politike, pesimizmin ekonomik dhe protestat dhe ndjenjat e shqetësimit si ndryshore të pavarura.

³ Gjatë analizave një grup shumë i kënaqur edhe për çështjet ekonomike e edhe politike nuk është marrë parasysh në analiza meqë numri i të anketuarve për këto grupe ka qenë shumë i vogël për të bërë analiza të duhura.


⁴ Drejtimi i ndikimit

Drejtimi i ndërveprimit është vështirë për t'u përcaktuar me anë të anketave. Për shembull, nuk ka mundësi për të ofruar shpjegime nëse ndjenja e shqetësimit shkakton perceptim më të lartë të shkallës së korruptionit apo ndoshta perceptimet e shkallës së korruptionit shkaktojnë shqetësime tek njerëzit. Sidoqoftë, mund të jemi të sigurt se këto rezultate tregojnë se ka marrëdhënie pozitive në mes të perceptimeve të korruptionit dhe ndjenjës së shqetësimit, pesimizmit politik, pesimizmit ekonomik, gatishmërisë për të protestuar për arsye politike dhe gatishmërisë për të protestuar për arsye ekonomike.

Korrupsioni dhe ofrimi i shërbimeve publike

Sipas kësaj ankete, rreth 10% e të anketuarve (apo rreth 125 persona) kanë raportuar se nga ta është kërkuar një "favor" i ndonjë lloji të caktuar kur ata kanë qenë duke iu qasur shërbimeve publike në ndonjë kohë të caktuar gjatë 12 muajve të kaluar.

Numri i përgjithshëm i njerëzve të cilët kanë përjetuar korrupsionin gjatë shfrytëzimit të shërbimeve ka ndryshuar në mes të 5% dhe 10% gjatë katër viteve të fundit, që nga koha kur korrupsioni është inkorporuar në anketat e SPH-së. Këto shifra ndryshojnë sipas përkatësisë etnike me ndryshimet më të mëdha të vërejtura tek bashkësia serbe. Në anketën e fundit, rreth 24% e serbëve kanë raportuar "kushtëzimin e shërbimit publik". "Kushtëzimi" ka qenë më i ulëti në mesin e pakicave të tjera etnike, me vetëm 5%, përderisa tek të anketuarit shqiptarë ka qenë 10%.



Diskutime dhe përfundime

Ka shumë pak të dhëna empirike për të nxjerrë konkluzione të prera rreth gjendjes së korrupsionit në Kosovë sot, por dëshmitë janë duke u mbledhur se numri i konsiderueshëm i qytetarëve janë duke gjetur se disa transaksione "nën tavolinë" janë të nevojshme për t'iu qasur shërbimeve themelore publike. Përpjekjet e fundit të qeverisë për të zbatuar strategjinë kundër korrupsionit për Kosovën meritojnë mbështetje të gjerë. Kjo nuk është vetëm rreth zënies së rasteve me profil të lartë, vlera të mëdha. Po ashtu ka të bëjë me të drejtat e të gjithëve për t'iu qasur shërbimeve themelore publike, nga të cilat varet secili kosovar.

Sipas Transparency International (TI)⁵, nëntë nga çdo dhjetë shtete në zhvillim kanë nevojë për të luftuar korrupsionin. Sipas Indeksit për Perceptimin e Kor-

rupsionit të TI-së, shtetet në regjionin e Ballkanit kanë nivele të larta të korrupsionit së bashku me 50% të botës në zhvillim.

Literatura për korrupsionin zbulon se karakteristikat e zakonshme në të gjitha shtetet me nivel të lartë të korrupsionit përfshijnë:

- Pjesa më e madhe e tyre janë të pazhvilluara apo në zhvillim. Dominojnë aktivitetet e ekonomisë së hirtë. Monopolet apo kompanitë shtetërore kanë pjesë të madhe në aktivitetet ekonomike; inflacioni apo hiperinflacioni ka qenë përjetuar në të kaluarën apo të tanishmen.
- Pjesa më e madhe e këtyre shteteve kanë përjetuar totalitarizmin dhe/ose konfliktet qytetare në të kaluarën. Edhe pse pjesa më e madhe kanë demokraci të zgjedhura dhe karakterizohen si demokraci, institucionet demokratike janë në nivele të ndryshme të zhvillimit.
- Papunësia është e lartë dhe shteti provon të zbusë papunësinë suke siguruar vende pune në shërbimin civil/sectorin publik. Ata të cilët janë të punësuar në shërbimin civil/sectorin publik kanë paga të ulëta dhe varësisht nga madhësia e familjes së tyre mund të konsiderohet se jetojnë nën apo afër kufirit të varfërisë.
- Shoqëria civile dhe media nuk janë të zhvilluara aq sa duhet apo janë të dobëta.

Krahas këtyre karakteristikave të zakonshme, puna zhvillimore zbulon se çrregullimet e politikave (ndryshimet e shpeshta në politika me rregulloret të cilat bien ndesh njëra me tjetrën dhe me politika të cilat nuk janë harmonizuar në mes të niveleve të ndryshme të qeverisë), nivelet e larta të pabarazisë së të hyrave dhe mungesa e konkurrencës, e cila është shpesh e pranishme krahas korrupsionit endemik. Nxjerra e argumenteve të qarta sa i përket shpeshhtësisë së manifestimit të kësaj është e vështirë. Pabarazitë në nivelin e të hyrave, mund të argumentohen edhe si arsye e edhe si pasojë e korrupsionit.

Në lidhje me këtë listë gjërash të ndërlidhura me korrupsionin – Kosova përmbush të gjitha kriteret.

Sipas analizave, perceptimet në pyetjet e ndryshme ekonomike dhe politike janë të ndërlidhura me perceptimet e korrupsionit dhe perceptimet e korrupsionit mund të shpijnë deri tek pesimizmi më i lartë

⁵ <http://www.transparency.org>

dhe ndjenja e shqetësimit, e cila në anën tjetër mund të shtyjë njerëzit deri tek rasti që ata të mos respektojnë sundimin e ligjit dhe të përmbushin obligimet e tyre si qytetarë.

Ngjashëm, literatura për korrupsionin zbulon se korrupsioni mund të jetë një rreth vicioz dhe mund të jetë mu ai që krijon dinamikën e tij dhe fuqizon vetveten. Për shembull kur papunësia është e lartë dhe qeveria është duke u ballafaquar me zgjedhjet, ajo mund të provojë të zbusë papunësinë duke ofruar vende të punës në shërbimin civil. Ky veprim tërheq pas vetes inflacionin, i cili bën që të ardhurat e nëpunësve civilë të bien, të cilët tani të ballafaquar me varfëri, shikojnë mundësi për të gjetur burime alternative përveç pagës së tyre. Rritja e korrupsionit mund të pengojë në investimet e drejtpërdrejta nga jashtë, krijon konkurrencën e pabarabartë dhe ndikon në përgjithësi në ekonomi, duke shkaktuar kështu papunësi të madhe.

Krizat me energji elektrike në Kosovë mund të jenë një ilustrim i mirë i këtij "rrethi vicioz". Një numër i konsiderueshëm i konsumatorëve në Kosovë nuk paguajnë drejtpërdrejtë energjinë e shpenzuar elektrike, sidoqoftë, në anën tjetër të gjithë kosovarët paguajnë energjinë elektrike përmes zhvillimit të dobët ekonomik, investimet e pakta dhe shkallën e lartë të papunësisë, të cilat ndërlikohen drejtpërdrejtë me furnizimin e paqëndrueshëm me energji elektrike. Për më tepër, kosovarët paguajnë për energjinë elektrike përmes tatimeve si dhe përmes transfereve nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës (BKK)⁶ KEK-ut në mënyrë që të financojë deficitin e krijuar nga borxhlinjtë e KEK-ut.

Është në interesin e qytetarëve të paguajnë faturat e tyre të energjisë elektrike dhe të kenë fondet e tyre nga BKK-ja të drejtuara kah rritja e pagave të shërbyesve civilë, për shembull, ose kah investimet në arsim dhe shëndetësi. Shumë pak nuk do të pajtoheshin me këtë argument. Kështu që përse sistemi nuk po punon? Është ndoshta sepse qytetarët nuk janë në dijeni për pasojat e korrupsionit apo ndoshta

për shkak se ata nuk konsiderojnë se mospagesën e energjisë elektrike si korrupsion? Diskutimet e kohëve të fundit dhe debati në media janë hapat e parë në drejtim të luftimit të korrupsionit. Hapi i radhës është për të krijuar konsensusin për këtë çështje dhe për të inkurajuar pranimin se diçka duhet të ndryshojë. Pa e zgjatur për çështjen e rastësisë, duhet të ketë një debat për politikën rreth asaj se ku duhet të thyhet ky rreth vicioz, para se intervenimi të mos jetë shumë vonë.

Global research ka treguar se liria e shtypit dhe pavarësia e gjyqësorit po ashti janë elemente të rëndësishme në reduktimin e në media dhe zhvillimit të një kulture të gazetarisë hulumtuese e cila është e fuqishme. Do të jetë vendimtare për të siguruar se palët relevante/akterët kanë qëndrim të njëjtë në drejtim të gjitha grupeve të interesit kur jemi tek korrupsioni – diçka që mund të thuhet se mungon, së paku tel me diat e Kosovës.

Sa i përket gjyqësorit dhe sistemit ligjor, parlamenti duhet të intensifikojë punën e tij për të siguruar vendosjen e një kornize të fortë legjislative. Autoritetet kosovare dhe bashkësia ndërkombëtare duhet të punojë në sistemet për të shtuar llogaridhënien e gjyqësorit, përderisa kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet krijimit të mekanizmave për mbikëqyrjen dhe përcjelljen e sektorit të sigurisë nga ana e shoqërisë civile, ndoshta diçka sikurse monitorimi që shoqëria civile bëri gjatë zgjedhjeve të fundit, që sigurisht se është një nga sukseset e Kosovës, veçanërisht kur krahasohet me regjionin. Në përgjithësi, demokracia nuk është vetëm për të votuar por edhe për të drejtën dhe përgjegjësinë për të mbikëqyrur institucionet demokratike dhe vlerësimin e përmbushjes së detyrave dhe funksioneve nga ana e tyre.

⁶ Vetëm për gjashtë vite (2002-2007) rreth 126 milionë euro (200 milionë dollarë amerikan) i janë transferuar KEK-ut nga BKK-ja. Shih RZHNUK 2007, Energjia për Zhvillim, UNDP Kosovë, 2007 (www.ks.undp.org).

Ngjarjet kryesore mediale, janar - qershor 2008:

Janar 2008

08/01/2008	Liderët kosovarë pajtohen për koalicionin qeverisës (VOA) Sllovenia hap rrugën për pavarësinë e Kosovës (AFP) BE-ja parasheh një pavarësi 'më pak se të plotë' për Kosovën (RFE)
09/01/2008	Thaçi shpall kabinetin e tij (të përditshmet) Katër serbë të akuzuar për sulm kundër PSSP-së dhe COMKFOR-it (të përditshmet)
10/01/2008	Kosova bëhet me institucionet e reja (të përditshmet) Nevojiten trajnime shtesë për transformimin e TMK-së (të përditshmet) Veteranët e luftës reagojnë ndaj ministrit Rashiq (të përditshmet)
12/01/2008	Sejdiu dhe Thaçi shprehen se janë duke koordinuar me komunitetin ndërkombëtar lidhur me shpalljen e pavarësisë (të përditshmet)
13/01/2008	Mesazhe nga veriu (të përditshmet) Të përditshmet kanë raportuar të dielën se Hashim Thaçi ka zgjedhur fshatin Çabër në veriu e Mitrovicës për vizitën e tij të parë në terren si kryeministër, duke dërguar mesazhin nga fshati Çabër se nuk do të ketë ndarje të Kosovës.
15/01/2008	Jeremiq: Kosova do të mund të ndahet (të përditshmet) SHBA premton të vazhdojë mbështetjen e Kosovës (të përditshmet) Granatë nën veturën qeveritare, 4 të plagosur (të përditshmet) Ministri i Punëve të Jashtme i Çekisë viziton Kosovën (të përditshmet) Thaçi udhëton drejtë OKB-së, e paqartë nëse do të flas ose jo (të përditshmet) Beogradi miraton planin e veprimit kundër pavarësisë së Kosovës (të përditshmet)
16/01/2008	Kuvajti ndër të parët që do të njohin pavarësinë e Kosovës (të përditshmet) Të përditshmet raportojnë për vizitën e kryetares së Kuvendit të Shqipërisë, Jozefina Topalli në Kuvajt, në Gjirin Persik ku ka pasur takime me Emirin e Kuvajtit. "Ne ju premtojmë që Kuvajti do të jetë vendi i parë nga rajoni ynë i cili do të njohë pavarësinë e Kosovës dhe unë besoj që edhe vendet e tjera do të marrin të njëjtin vendim," është shprehur Emiri.
18/01/2008	Rehn: Kosova është çështje evropiane (të përditshmet) Qeveria zotohet të hartoj ligjet që dalin nga pakoja e Ahtisarit (të përditshmet) Veriu i Kosovës – oazë e kontrabandës me karburante (të përditshmet)
19/01/2008	Thaçi: Kosova në duar të Brukselit dhe Uashingtonit (të përditshmet) Nicholas Burns jep dorëheqjen (të përditshmet) Kosova duhet të merr fatin e saj në duart e veta (të përditshmet) AAK nuk e largon, por e "liron" Agim Çekun (të përditshmet) Rasti i Gorazhdecit transferohet nga gjykata komunale tek ajo e qarkut (të përditshmet) Jessen-Petersen: Shpallja e pavarësisë brenda muajit (të përditshmet)
23/01/2008	Rücker: Kosova është shumë afër qëllimit (të përditshmet) Thaçi kufizon privilegjet e zyrtarëve institucional (të përditshmet)
26/01/2008	Topi: Pavarësia ka arritur ndalesën përfundimtare (të përditshmet) Thaçi pranon garanci nga NATO lidhur me sigurinë e Kosovës (të përditshmet) SHBA thërret për zgjidhje të shpejtë të statusit të Kosovës (të përditshmet)

29/01/2008	<p>Ki-moon: Kosova është çështje evropiane (të përditshmet)</p> <p>Moska: Shpallja e pavarësisë sjellë tek ndarja "de facto" (të përditshmet)</p> <p>Rusia planifikon masa në rast të shpalljes së njëanshme të pavarësisë (të përditshmet)</p> <p>Thaçi: Përgatitjet për shpalljen e pavarësisë janë në fazën përfundimtare (të përditshmet)</p> <p>SNC: Nikoliq do të mbrojë Kosovën (të përditshmet)</p>
31/01/2008	<p>Thaçi koordinon veprimet me TMK-në dhe SHPK-në (të përditshmet)</p> <p>Kurti prapë nën arrest (të përditshmet)</p> <p>Tadiq në Kosovë për fushatë (të përditshmet)</p>
Shkurt 2008	
02/02/2008	<p>Thaçi: Nuk do të ketë më shtyrje të statusit (të përditshmet)</p> <p>Serbët shprehen se kurrë nuk do të jenë pjesë e pavarësisë (të përditshmet)</p> <p>Steinmeier: BE-ja është duke u përgatitur për misionin e saj në Kosovë (të përditshmet)</p>
05/02/2008	Steinmeier: Kosova nuk është Tajvan (të përditshmet)
07/02/2008	OSBE ndoshta me një mandat ndryshe (të përditshmet)
08/02/2008	<p>Kaidanov: Misioni i BE-së, garanci për të gjithë (të përditshmet)</p> <p>Lirohet Kurti, suspendohet procesi kundër tij (të përditshmet)</p>
11/02/2008	Walker: Çdokush duhet të kujtoj arsyet pse Kosova kërkon pavarësi (të përditshmet)
12/02/2008	Thaçi: KEK, PTK dhe Aeroporti janë kampionët e korrupsionit (të përditshmet)
13/02/2008	<p>Churkin: Serbia kërkon mbledhje të jashtëzakonshme të Këshillit të Sigurisë (Koha ditore)</p> <p>Thaçi: KEK-u është duke sabotuar pavarësinë (të përditshmet)</p>
14/02/2008	Bashkimi Evropian nuk e bind Rusinë në lidhje me Kosovën (të përditshmet)
15/02/2008	<p>Thaçi deklaron se gjendja e energjisë elektrike, është krizë shtetërore</p> <p>Pavarësia do të shpallet me himnin e Kosovës</p> <p>Putin e çuan shpalljen e pavarësisë 'imorale'</p> <p>Rice shpreson që Serbia do të pranojë pavarësinë e Kosovës (të përditshmet)</p> <p>Franca do të njuh pavarësinë e Kosovës të hënën (të përditshmet)</p> <p>"Garda e Car Llazarit" shpërndan fletushka në Kosovë, kërcënon me bllokadë më të gjerë (të përditshmet)</p> <p>Jeremiq: Serbia nuk e pranon pavarësinë, por nuk do ta kundërshtojë atë me dhunë (të përditshmet)</p>
16/02/2008	Sarkozy: Mësohuni me hartën e re të Evropës, me Kosovën në të (të përditshmet)
17/02/2008	<p>Thaçi konfirmon datën (të përditshmet)</p> <p>Pas takimit me liderët fetar kosovarë, mufti Naim Tërnavë dhe peshkopin Dodë Gjergji, kryeministri i Kosovës Thaçi ka thënë se e diela do të jetë dita kur do të përbushet vullneti i popullit të Kosovës. "Nesër do të jetë ditë e qetë, e mirëkuptimit dhe përpjekjeve shtetërore për të përbushur vullnetin e qytetarëve të Kosovës," ka thënë Thaçi. Ai ka shtuar se autoritetet e Beogradit mund të kenë ndikim në zhvillimet në Kosovë.</p> <p>Krasniqi: Ne do ta shpallin sot (Epoka e Re)</p> <p>Presidenti i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, ka konfirmuar se pavarësia e Kosovës do të shpallet sot dhe se Kuvendi ka bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për shpalljen e pavarësisë "Deklarata e pavarësisë së Kosovës do të lexohet gjatë seancës," ka thënë Krasniqi.</p>
18/02/2008	<p>Kosova bëhet shteti më i ri në botë (të përditshmet)</p> <p>Sejdiu informon Ban Ki-moon mbi shpalljen e pavarësisë (Zëri)</p> <p>Serbët sulmojnë ambasadën amerikane (Zëri)</p> <p>Shpërthim në oborrin e gjykatës në veri (Koha Ditore)</p>

19/02/2008	Serbët e Kosovës protestojnë kundër shpalljes së pavarësisë (të përditshmet) Franca dhe Britania thyejnë akullin rreth Kosovës (të përditshmet) Shqipëria njeh Kosovës menjëherë pas SHBA-ve (të përditshmet) OKB-ja nuk mund të anulojë pavarësinë e Kosovës (të përditshmet)
20/02/2008	Shkatërrohen pikat kuftare me Serbinë, KFOR-i merr kontrollin (të përditshmet) Dhjetë ligje të miratuara brenda një ore (të përditshmet) Serbia thërret OSBE-në të dënoj pavarësinë e Kosovës (të përditshmet) Solana: BE-ja do të shtrihet në gjithë territorin e Kosovës (të përditshmet) Ambasadat e para të Kosovës hapen në qershor (të përditshmet)
22/02/2008	Koshtunica nxitë serbët, ambasada amerikane merr flakë (të përditshmet) Incidentet në veri tregojnë se KFOR-i ka punë për të bërë në Kosovë (të përditshmet) Gjashtë shtete të reja njohin zyrtarisht pavarësinë e Republikës së Kosovës (të përditshmet) Serbët shpallin të vdekur Presidentin e SHBA-ve, Bush (të përditshmet)
23/02/2008	Burns: Rusia duhet të jetë e kujdesshme lidhur me Kosovën (të përditshmet) Thaçi: Çdo pjesë e territorit të Kosovës është e mbrojtur (të përditshmet) Kaidanow: Nuk do të ketë asnjë ndarje të Kosovës (të përditshmet)
28/02/2008	Kosova do të kërkojë anëtarësim në organizatat ndërkombëtare (të përditshmet) Gjermania transformon zyrën e vet në Kosovë në ambasadë (Zëri) Shtylla e IV e UNMIK-ut pret sinjale nga Ban Ki-moon (Koha ditore) Serbët e Kosovës kërkojnë kthimin e trupave ruse në Kosovë (Koha ditore)
29/02/2008	Mblidhet grupi drejtues ndërkombëtar për Kosovën (të përditshmet) Eksplodim afër gjykatës në veriun e Mitrovicës (Koha ditore)
Mars 2008	
03/03/2008	Vetëvendosja thotë se Kosova po shkon drejtë ndarjes (të përditshmet) Aleksyev: Do të bëjmë gjithçka për të anuluar pavarësinë (të përditshmet)
04/03/2008	Serbia "pushton" hekurudhat në veriun e Kosovës (të përditshmet) Barroso: Jo BE, por Këshilli i Sigurimit nuk ka qenë në gjendje të zgjedhë statusin e Kosovës (të përditshmet)
05/03/2008	Kosova rimerr hekurudhat (të përditshmet) Suedia dhe Holanda njohin shtetin e Kosovës (të përditshmet)
06/03/2008	Rücker thotë në veri se nuk do të ketë ndarje (të përditshmet) Churkin: Kosova de facto e ndarë (të përditshmet)
07/03/2008	Holbrooke: Pavarësia – zgjidhja më e mirë (të përditshmet) Solana: Përveç Kosovës, BE-ja nuk do të njeh republika të tjera (të përditshmet)
10/03/2008	Kosovarët presin transferim gradual të kompetencave (Koha Ditore) Edhe pse OKB-ja ende nuk ka marrë një vendim për mbylljen e misionit të vet në Kosovë, kosovarët presin që transferimi i kompetencave nga UNMIK-u të përfundojë brenda 120 ditëve.
12/03/2008	Pas kërkesës së Serbisë, Këshilli i Sigurimit diskuton lidhur me Kosovën (të përditshmet) Ban Ki-moon: Kosova rast unik (Koha ditore, Zëri)
13/03/2008	UNMIK-u nuk din se si ka hyrë treni i Serbisë në Kosovë (të përditshmet) Kuvendi miraton 10 projektligje nga pakoja e Ahtisarit (të përditshmet) Arrestohet një serb në Pejë nën dyshimin për kryerjen e krimeve të luftës (të përditshmet)
14/03/2008	Kermabon shpall fillimin e misionit të EULEX-it (të përditshmet)
17/03/2008	Maqedonia pa një pozitë lidhur me njohjen e pavarësisë së Kosovës (të përditshmet)

18/03/2008	KFOR-i merr veriun me forcë (të përditshmet) NATO: Do të vazhdojmë të përgjigjemi në mënyrë të vendosur kundër sulmeve (të përditshmet) Tadiq: UNMIK-u dhe KFOR-i përdorin forcë të tepruar (të përditshmet)
19/03/2008	UNMIK-u dhe KFOR-i : Beogradi është përgjegjës (të përditshmet) Vdes një polic ukrainas i UNMIK-ut (të përditshmet) Trembëdhjetë të plagosur në përlshje në Prishtinë (të përditshmet)
21/03/2008	Bush autorizon furnizimin e Kosovës me pajisje ushtarake (të përditshmet) Liderët kosovarë ofrojnë garanci për lirimin e Ramush Haradinajt (të përditshmet)
23/03/2008	Beogradi propozon ndarje etnike (të përditshmet) Wisner: Beogradi të ndalë praninë e vet ilegale në Kosovë (të përditshmet)
27/03/2008	Europarlamentarët premtojnë të ndihmojnë Kosovën (të përditshmet) McCain: Kosova ka shokë të fuqishëm në SHBA (të përditshmet)
31/03/2008	Përlshen në veri serbët dhe shqiptarët (të përditshmet) Kurti mobilizon fshatarët kundër decentralizimit (Koha ditore)
Prill 2008	
01/04/2008	Rexhepi takon Galluccin në Mitrovicë (të përditshmet) Kermabon: "EULEX-i do të dislokohet në gjithë Kosovën (të përditshmet) Spanja nuk dëshiron të jetë pjesë e misionit të BE-së në Kosovë (të përditshmet)
04/04/2008	Haradinaj dhe Balaj të pafajshëm, Brahimaj dënohet me gjashtë vite (të përditshmet) UNMIK-u transformohet në zyrën e Organizatës Kombeve të Bashkuara në Prishtinë (Koha ditore) Gallucci largohet në fund të majit (Koha ditore, Express) Skender Hyseni marr miratimin e Thaçit për t'u bërë ministër i Punëve të Jashtme (të përditshmet)
05/04/2008	Kuvendi komunal i Mitrovicës kërkon largimin e Galluccit (të përditshmet)
08/04/2008	Nënshkruhet Kushtetuta evropiane e Kosovës (të përditshmet) Gallucci njofton mbi largimin e tij nga Kosova (Zëri, Express)
09/04/2008	SHBA-ja hap ambasadën e vet në Kosovë (të përditshmet) UNMIK-u i gatshëm të lejoj zgjedhjet serbe në Kosovë (Koha ditore)
11/04/2008	Rücker: Serbia nuk mund të organizojë zgjedhje lokale në Kosovë (të përditshmet) Ban Ki-moon: Kosova nuk do të kthehet në status quo (të përditshmet)
14/04/2008	Rupel: Kosova nuk mund të ndahet pasi që nuk ka serbë vetëm në veri (të përditshmet)
15/04/2008	Sejdiu kritikon Rücker-in për butësi ndaj kërkesave të Serbisë (Koha ditore) Samardzic thërret Rücker-in të shpall zgjedhjet lokale në Kosovë (të përditshmet)
16/04/2008	Merkel: Kosova mbetet rast unik (të përditshmet) "Çohu" thotë se qeveria lufton korrupsionin me retorikë (të përditshmet) Rossin mund të lëshoj Kosovën për shkak të "konfliktit" me Gallucin (të përditshmet) Rupel: Kushtetuta lejon Kosovën të kontrolloj shtetin (të përditshmet)
17/04/2008	Rusia është po ashtu kundër zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë (të përditshmet) "Vetëvendosje", proteston me 9 maj kundër zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë (të përditshmet)
18/04/2008	SHPK-ja po destabilizon veriun (të përditshmet) Beogradi vendos të mbajë zgjedhjet lokale në Kosovë (të përditshmet)
19/04/2008	Kuvendi i Kosovës debaton programin qeveritar (të përditshmet) Thaçi dhe Tadiq në Këshillin e Sigurimit (të përditshmet) Prishtina dhe Shkupi nënshkruajnë protokollin e demarkacionit (të përditshmet) Pack: Të punohet që serbët të kenë besim në Kushtetutën e Kosovës (të përditshmet)

24/04/2008	Delegacioni i Kuvendit Parlamentar të NATO-s viziton Kosovën (të përditshmet) Rücker merr dritën e gjelbër për rikonfigurimin e UNMIK-ut (të përditshmet)
Maj 2008	
05/05/2008	Beogradi dëshiron të përdorë vizitën e Guéhenno për pajtim me UNMIK-un (Zëri) Guéhenno: UNMIK-u do të ndryshojë (të përditshmet)
07/05/2008	De Guht: BE-ja nënshkruan MSA-në me Serbinë pa Kosovën (të përditshmet) Pavarësia ndryshon 'fjalorin' e OSBE-së (të përditshmet)
08/05/2008	UNMIK-u nuk do të përdorë forcën kundër zgjedhjeve lokale të Serbisë në Kosovë (të përditshmet) Sejdiu: Koshtunica dhe Samarxhiq – persona të padëshiruar në Kosovë (të përditshmet)
09/05/2008	Sot "Vetëvendosja" do të protestojë kundër UNMIK-ut (të përditshmet) Sali Berisha: Zgjedhjet e Serbisë, ndarje e butë e Kosovës (të përditshmet)
13/05/2008	Ban Ki-moon heziton të mbështes Feith si shef të ri të UNMIK-ut? (Zëri) Thaçi: Serbia do të njoh realitetin e ri në Kosovë pas zgjedhjeve (të përditshmet)
14/05/2008	Haga liron përkohësisht Astrit Haraçinë dhe Bajrush Morinën (të përditshmet) Katër serbë të Gorazhdecit akuzohen për kërcënim ndaj Rücker dhe De Marnhac (të përditshmet)
16/05/2008	Admirali Fitzgerald viziton Mitrovicën (të përditshmet) Ponos: Rusia dhe Spanja kundërshtojnë trajnimin e Ushtrisë së Kosovës nga NATO-ja (të përditshmet)
17/05/2008	Moore: Njohja e Kosovës, vendim delikat për Malin e Zi (të përditshmet) 15 qershori, e paarrishme për EULEX-in (të përditshmet)
19/05/2008	Kermabon: "Misioni i EULEX-it është ekskluzivisht evropian, jo i OKB-së (të përditshmet) Haga nuk do të heton pretendimet mbi trafikimin e organeve njerëzore nga UÇK-ja (Koha ditore)
21/05/2008	Kouchner dhe zyrtarët rusë diskutojnë sot lidhur me Kosovën (të përditshmet) Baton Haxhiu në Hagë (të përditshmet)
23/05/2008	Grupi drejtues ndërkombëtar mban takim në Prishtinë (të përditshmet) Haradinaj – prania e UNMIK-ut nuk është legjitime pas 15 qershorit (të përditshmet) DiCarlo: Pavarësia e Kosovës është e pakthyeshme (të përditshmet)
24/05/2008	Kuvendi miraton Ligjin mbi festat zyrtare (të përditshmet) Gjykata e Hagës liron Baton Haxhiun (të përditshmet)
26/05/2008	Kosova merr pjesë në seancën e Parlamentit Evropian (të përditshmet)

28/05/2008	Haradinaj vazhdon akuzat ndaj qeverisë Thaçi (të përditshmet) Substanca e dëmshme helmon policët në Vërmicë (të përditshmet) Jansha: Nëse paqja vazhdon në Kosovë pas 15 qershorit, do të jemi të gëzuar (të përditshmet)
30/05/2008	Parlamenti Evropian trajton Kosovën si shtet (të përditshmet)
31/05/2008	Krasniqi: Kushtetuta e Kosovës sqaron kompetencat e ndërkombëtarëve (të përditshmet) Qeveria nuk lejon suspendimin pa pagesë për zyrtarët policorë serbë (të përditshmet)
Qershor 2008	
01/06/2008	Ban dhe Solana nuk pajtohen mbi marrëdhëniet UNMIK-EULEX (Zëri) Jeremiq kërkon mbështetje e OAS për rezolutën e Serbisë (të përditshmet)
04/06/2008	Ban t'i ofroj partneritet Beogradit lidhur me Kosovën (të përditshmet) Sejdiu: Strukturat paralele serbe të eliminohen nga Kosova (Zëri)
05/06/2008	UNMIK-u kërkon maturi nga institucionet e Kosovës lidhur me veriuin pas të 15-tit (të përditshmet) Rohan: Prania paralele e dy misionëve krijon një gjendje absurde (të përditshmet) Rexhepi shpallë muajin e mbylljes së doganave në veri (Koha ditore)
06/06/2008	Svilanoviq: Marrëveshja ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës e mundshme (të përditshmet) Kuvendi i Kosovës miraton pesë ligje të tjera nga pakoja e Ahtisarit (të përditshmet) Feith, Ferati dhe Trajkoviq diskutojnë decentralizimin (të përditshmet)
07/06/2008	Serbët në veri formojnë komunën e Mitrovicës (të përditshmet) Haradinaj: Lobimi ka dështuar; UNMIK-u duhet të largohet (të përditshmet)
08/06/2008	Kapet personi i cili ka tentuar të hyjë në shtëpinë e kryeministrit (të përditshmet) Crvenkovski mohon të ketë marrë sugjerime nga Medvedev lidhur me Kosovën (Koha ditore)
10/06/2008	Kosova pranon dualizmin UNMIK-ICO (të përditshmet) Mali i Zi nën presion të Serbisë përkitazi me Kosovën (Koha ditore) Lavrov: Rusia dëshiron rifillimin e bisedimeve Beograd – Prishtinë (të përditshmet)
12/06/2008	UNMIK-u redukton personelin e vet për 70% pas 15 qershorit (Zëri) Kuvendi miraton himnin shtetëror (të përditshmet) Sejdiu i jep ultimatum UNMIK-ut deri në vjeshtë (Koha ditore)
16/06/2008	Bush autorizon ushtrinë amerikane në Kosovë për bashkëpunim të ri pas 15 qershorit (Koha ditore) Garda e Car Llazarit përgjegjëse për sulmin ndaj policisë në Mitrovicë (të përditshmet)
17/06/2008	Rücker konfirmon largimin e tij; ende nuk ka vendim për shefin e ri të UNMIK-ut (të përditshmet)

